



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

RAPORT
(Përfundimtar)

PËR
MBIKËQYRJEN E LIGJSHMËRISË NË ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT
CIVIL

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
TIRANË

Tiranë, Dhjetor 2021

RAPORT

Për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), Tiranë.

Hyrje

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në zbatim të planit vjetor të mbikëqyrjes dhe të Vendimit nr. 67, datë 10.6.2021, “Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, në institucionin Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në institucionin Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), Tiranë.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), është organ publik, i pavarur, i krijuar me ligj, i cili e zhvillon veprimtarinë e tij në përputhje me ligjin nr. 10221, datë 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar me ligjin nr. 124/2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ku si objekt të tij ka rregullimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit me qëllim që të sigurojë të drejtën çdo personi për:

- a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji;
- b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike;
- c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin.

Komisioneri për përmbushjen e misionit dhe detyrave të ngarkuara me ligj, mbështetet nga Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Mënyra e funksionimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, parashikohet në Kreun V, të ligjit të sipërcituar, ku në nenin 21, pika 3 përcaktohet se:

“Kuvendi vendos për pagën e komisionerit, strukturën organizative dhe klasifikimin e pagave për punonjësit e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Punonjësit e kësaj zyre, gëzojnë statusin e nëpunësit civil.”

Kjo do të thotë që, për të gjithë punonjësit që janë në pozicione pune pjesë e shërbimit civil si më sipër, zbatohet ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke filluar që nga momenti i rekrutimit, pra, pranimi në shërbimin civil dhe duke vazhduar me të gjitha procedurat që ndiqen gjatë aplikimit të instituteve të ligjit.

Evidentojmë faktin se, edhe para fillimit të efekteve juridike të këtij ligji, mënyra e fillimit dhe mbarimit të marrëdhënieve të punës, për punonjësit e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, janë rregulluar me ligjin nr. 8549, datë 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”, i zbatueshëm për atë kohë, tashmë i shfuqizuar.

Nga sa më sipër, duke qenë se ky institucion përfshihet në skemën e shërbimit civil, e bëjnë atë subjekt të kësaj mbikëqyrjeje.

Procesi i mbikëqyrjes në këtë institucion, filloi në datën 14.6.2021 në zbatim të Programit të Mbikëqyrjes nr. 662/1 prot., datë 10.6.2021, të miratuar nga Komisioneri, njoftuar institucionit me shkresën nr. 662/2 prot., datë 10.6.2021, “Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në institucionin Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Objekti i mbikëqyrjes është i përgjithshëm në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimit në shërbimin civil; lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjit me detyra specifike të administrimit të këtij procesi.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm në institucion, grupi i punës, i përbërë nga inspektorët ***** dhe *****; nën drejtimin e Drejtorit të Mbikëqyrjes, *****; përpunoi të dhënat dhe përgatiti projektraportin e mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD).

Ky material, me shkresën nr. 662/4 prot., datë 28.10.2021, u dërgua për njohje, pranë institucionit, duke i lënë 5 ditë kohë për të paraqitur observacionet e tyre në lidhje me gjetjet e grupit të punës.

Subjekti i mbikëqyrur, pasi është njohur me projektraportin dhe gjetjet e grupit të punës, me shkresën nr. 894/3 prot., datë 08.11.2021, ka dërguar të nënshkruar projektraportin pa vërejtje, i cili është administruar në dosjen e mbikëqyrjes.

Qëllimi i mbikëqyrjes

Qëllimi i realizimit të mbikëqyrjes është:

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.
- Paraqitja para përgjegjësve për administrimin e shërbimit civil, njësisë së burimeve njerëzore dhe titullarit të institucionit, e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil.
- Paralajmërimin e institucionit dhe lënien e detyrave për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.

Objekti i mbikëqyrjes

1. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, gjatë aplikimit në praktikë të procesit të pranimit në shërbimin civil dhe zhvillimit të sistemit të karrierës nëpërmjet lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë.
2. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil.
3. Plotësimi i pozicioneve të lira në shërbimin civil në nivelin ekzekutiv, nëpërmjet konkurrimit dhe si janë respektuar kërkesat e nenit 22 dhe akteve nënligjore në lidhje me dy fazat e këtij procesi:
 - verifikimi paraprak nga njësia përgjegjëse, nëse konkurrentët i plotësojnë kërkesat e përgjithëshme dhe të veçanta të vendit të punës;
 - vlerësimi i kandidatëve nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit.
4. Emërimet në shërbimin civil pas përfundimit të procesit të konkurrimit dhe menaxhimi i listës së kandidatëve fitues që kanë arritur pikët, por që nuk janë emëruar. Evidentimi i rasteve të emërimit pa konkurrim, në kundërshtim me kërkesat e nenit 23 të ligjit për nëpunësin civil.
5. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës (*si janë zbatuar detyrimet e nëpunësit dhe eprorit si dhe procedura e vendimmarrjes në përfundim të kësaj periudhe*).

6. Lëvizja paralele në kategorinë ekzekutive dhe respektimi i kërkesave ligjore të parashikuara në nenin 25 të ligjit për nëpunësin civil, gjatë zhvillimit të kësaj procedure nga Komisioni i Brendshëm.
7. Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese dhe respektimi i procedurave të kërkuara nga neni 26 i ligjit për nëpunësin civil, nga njësia përgjegjëse dhe Komiteti i Pranimit gjatë zhvillimit të dy fazave të konkurrimit:
 - verifikimit paraprak;
 - vlerësimi i kandidatëve.
8. Pranimi i nëpunësve civilë të kategorisë së lartë drejtuese dhe respektimi i kërkesave të nenit 32 të ligjit për nëpunësin civil nga ana e titullarit të institucionit (*respektimi i kufirit prej 15% të pranimit nga jashtë shërbimit civil*); respektimi i kërkesave ligjore nga ana e njësisë përgjegjëse për organizimin e konkurrimit dhe respektimi i procedurave të konkurrimit nga ana e Komisionit të Përhershëm të Pranimit, gjatë realizimit të procesit.
9. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (njësisë përgjegjëse), gjatë punës për zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.

Metodologjia e mbikëqyrjes

Grupi i mbikëqyrjes ka zgjedhur si metodë pune verifikimin e dokumentacionit që ka lidhje me objektin e mbikëqyrjes, i cili administrohet në dosjet individuale të personelit, në arkivën e institucionit, si dhe në sektorin e shërbimeve mbështetëse, për çdo nëpunës të emëruar në pozicion pune pjesë e shërbimit civil.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, grupi i punës ndërmori veprimet e mëposhtme:

- U verifikuan pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil, sipas organigramës dhe strukturës, për institucionin Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD)

- U verifikuan procedurat e rekrutimit dhe përmbajtja e dosjeve individuale të çdo nëpunësi civil, si dhe çdo e dhënë tjetër e kërkuar nga ligji për plotësimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil.
- U verifikuan përshkrimet e punës për pozicionet e punës pjesë e shërbimit civil, nëse ato janë të hartuara në përputhje me formatin standard të miratuar.
- U verifikuan formularët e vlerësimit të punës në lidhje me vlerësimin e rezultateve në punë për të gjithë nëpunësit civilë në periudhë prove dhe, nëse ky proces, është kryer sipas kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.
- U verifikuan të dhënat profesionale, si dhe të dhënat e tjera në lidhje me marrëdhëniet e punës, të çdo nëpunësi të rekrutuar rishtas, për të provuar përmbushjen e kërkesave të posaçme të vendit të punës, si arsimi, përvoja në punë e të tjera.

Konstatimet janë të materializuara si tabela më vete (*Aneksi 1; Aneksi 2; Tabela 1; Tabela 2; Tabela 3; Tabela 4 dhe Tabela 5*), të cilat janë pjesë e këtij raporti.

- I. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë të institucionit në momentin e fillimit të efekteve të ligjit.**

1. Situata e administrimit të burimeve njerëzore në momentin e mbikëqyrjes.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është institucion i pavarur i krijuar me ligj, organizimi i brendshëm i të cilit bëhet mbi bazën e strukturës dhe organikës që miratohet nga Kuvendi i Shqipërisë, si dhe të Rregullores së Brendshme, të miratuar nga Komisioneri, në zbatim të nenit 39, pika 1, të ligjit nr. 10221, datë 4.2.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar.

Nisur nga analiza e dokumentacionit që është vënë në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes, konstatohet se, në momentin e fillimit të efekteve juridike të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, (datë 26.2.2014), KMD, ka qenë i organizuar dhe funksiononte mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr. 34, datë 20.5.2010, të Kuvendit, “*Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”. Bazuar në këtë strukturë organizative, rezulton se, ky institucion, në këtë periudhë, ka patur gjithsej **23** pozicione pune, nga të cilat, **18 pozicione pune janë pjesë e shërbimit civil.**

Më pas, është miratuar nga Kuvendi, struktura dhe organika sipas Vendimit nr. 88/2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin e Kuvendit nr. 34, datë 20.5.2010, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, e cila është në fuqi edhe në momentin e realizimit të mbikëqyrjes.

Sipas kësaj strukture, institucioni i KMD, ka gjithsej **34** pozicione pune, të organizuara në këtë mënyrë:

- ✓ **1** pozicion pune është **funksionar i lartë shtetëror** (Komisioneri);
- ✓ **1** pozicion pune **kabineti** (Këshilltar)
- ✓ **28** pozicione pune janë **pjesë e shërbimit civil**;
- ✓ **4** pozicione pune janë **punonjës administrativë** (1 sekretar; 1 magazinier; 1 pastrues; 1 drejtues automjeti).

Nga sa më sipër, struktura dhe organika, në përmbajtjen e saj, ka të evidentuar në mënyrë të qartë pozicionet e punës të kategorizuar sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar:

- ✓ për funksionarët e lartë të institucionit;
- ✓ pozicionet e punës ndaj të cilëve zbatohet ligji për nëpunësin civil;
- ✓ pozicionet e punës që kryejnë funksione administrative.

Nisur nga përmbajtja e strukturës, konstatohet se, organizimi i saj, mbështetet në legjislacionin material për të garantuar mbrojtjen efektive nga diskriminimi si dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. Gjithashtu kjo strukturë, përmbush edhe standartet e vendosura për funksionimin e saj sipas ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ku përcaktohen kriteret dhe parimet e organizimit dhe funksionimit të administratës shtetërore.

Konstatohet se struktura e KMD, është e organizuar në nivel drejtorie ku, në përcaktimin e numrit të punonjësve për çdo drejtori, institucioni është orientuar në përcaktimet e Vendimit nr. 893, datë 17.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”, i cili ka dalë në mbështetje të ligjit për organizimin e administratës shtetërore.

Vërehet se në krijimin e **drejtorive** është mbajtur parasysh orientimi i pikës 23, të aktit nënligjor të cituar më sipër, që, *një drejtori mund të krijohet nëse ka në përbërje të saj të paktën dy sektorë ose nëse ka të paktën 5 (pesë) punonjës.*

Në rastin konkret, rezultojnë 5 drejtori si më poshtë:

- ✓ Drejtoria e Pritjes së Ankesave (1 Drejtor; 5 Specialistë – 2 në qendër; 1 në Shkodër, 1 në Fier, 1 në Korçë);
- ✓ Drejtoria e Hetimit Administrativ (1 Drejtor; 5 Inspektorë).
- ✓ Drejtoria Juridike (1 Drejtor; 4 Specialistë)
- ✓ Drejtoria e Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit (1 Drejtor; 5 Specialistë)
- ✓ Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse (1 Drejtor; 4 Specialistë dhe 3 punonjës funksione administrative)

Konstatohet se, “*Drejtoria e Pritjes së Ankesave*”, paraqitet e organizuar në nivel qendror dhe rajonal, ku zyrat rajonale në Shkodër, Korçë dhe Fier, kanë secila nga 1 specialist të cilët zbatojnë planin dhe udhëzimet e eprorit për zhvillimin korrekt dhe në përputhje me dispozitat ligjore të Zyrës së Komisionerit për pritjen e ankesave, ku përfshihen organizimi i pritjes së ankesave, sistemimi i ankesave, dhënia e përgjigjeve të menjëhershme në afat ligjor dhe transferimin e rasteve te njësia përkatëse e KMD, për trajtim të mëtejshëm të specializuar, si dhe aktivitete të tjera duke koordinuar punën me Zyrën e Komisionerit.

Evidentojmë faktin se Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, paraqitet edhe si **njësi përgjegjëse** në administrimin e shërbimit civil të institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, e përcaktuar kjo edhe në nenin 27, të Rregullores së Brendshme të institucionit, të miratuar me Urdhrin nr.65, datë 21.5.2021, të Komisionerit, “*Për miratimin e rregullores së Brendshme të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD)*”.

Klasifikimi i pozicioneve në shërbimin civil, është bërë mbi bazën e përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe Vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, të ndryshuar me Vendimin nr. 262, datë 25.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për disa ndryshime në Vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, ku, për çdo pozicion pune, është mbajtur parasysh natyra e pozicionit sipas specifikave të tij, si dhe përshkrimi i punës.

Në rastin konkret, 28 pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil në institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten në këtë raport:

- Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues, janë **5** pozicione pune, ose rreth **18 %** të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin pozicionit “*Drejtor Drejtorie*”.
- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues janë **4** pozicione pune, ose rreth **14 %** të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin pozicionit “*Inspektor*”.
- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive, janë **19** pozicione pune, ose **68 %** të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, të cilat i përkasin pozicionit “*Specialist*”.

Më tej, konstatohet se, struktura organizative për pozicione të punës pjesë e shërbimit civil dhe niveli i pagave, është në përputhje edhe me përcaktimet e Vendimit nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve..., disa institucione të pavarura...*”, ku përfshirja e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në fushën e veprimit të këtij vendimi është parashikuar në pikën 1, paragrafi 1/1, të tij.

Përsa i përket pozicionit të punës “*Inspektor*” (4 pozicione), konstatohet se, institucioni i ka klasifikuar “*nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues*”. Ky klasifikim është bërë nisur nga kategorizimi i pagës III-a, që i përket kësaj klase të nëpunësisë. Në nenin 19, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, pika 6, përcaktohet se, *nëpunës civilë të kategorisë së ulët drejtuese janë pozicionet a) shef sektori dhe b) pozicionet e barasvlershme me të*, siç është rasti konkret, pozicioni “*Inspektor*”.

Kategorizimi i këtij pozicioni është përcaktuar në Vendimin nr. 107, datë 6.3.2019, të Këshillit të Ministrave, “*Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të KM...*”, i cili, në Lidhjen nr.3, të këtij vendimi, “*Kategorizimi për pozicionet e veçanta të punës për funksionet e veçanta në Kryeministri, ministrinë e linjës dhe institucionet e pavarura*”, ka shtuar pozicionin “*Inspektor*”, kategoria e pagës III-a, për institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Ky ndryshim është pasqyruar edhe në Vendimin nr. 57/2019, të Kuvendit të Shqipërisë, “*Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr. 34, datë 20.5.2010, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”* të ndryshuar, ku emërtesa “*Inspektor*”, është klasifikuar në nivelin III-a.

Konstatohet se, institucioni funksionon mbi bazën e Rregullores së Brendshme, e cila, siç e thamë në pjesën hyrëse të materialit, është miratuar nga Komisioneri me Urdhrin nr. 65,

datë 21.5.2021, në të cilën, janë përcaktuar rregullat procedurale për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të administratës, si dhe janë evidentuar përgjegjësitë dhe detyrat kryesore që duhet të përmbushë çdo drejtori, në përputhje me rolin dhe misionin e këtij institucioni.

Vlerësojmë se, në rregulloren e brendshme të institucionit, janë pasqyruar parimet dhe rregullat që sanksionon ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe detyrat specifike që duhet të kryejë secili prej pozicioneve të punës që janë pjesë e shërbimit civil, të cilat materializohen edhe në përshkrimin e punës, në përputhje me ligjin për shërbimin civil.

Konkluzion: Nga sa më sipër, nga analiza e përmbajtjes së strukturës, Komisioneri vlerëson se, institucioni i mbikëqyrur, është i organizuar mbështetur në strukturën organizative hierarkike dhe në përmbajtjen e saj prezantohet statusi i punësimit të punonjësve, i ndarë në tre nivele *a) funksionarë shtetërorë, b) nëpunës civilë dhe c) punonjës administrativë*, si dhe është përcaktuar klasifikimi i pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, sipas nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe kategoria e tyre e pagës. Numri i punonjësve për çdo njësi administrative, është brenda kufirit të miratuar.

2. Mënyra e plotësimit të pozicioneve të shërbimit civil në momentin e realizimit të mbikëqyrjes.

Nga kontrolli i ushtruar, si dhe nga materialet që na janë vënë në dispozicion nga njësia e burimeve njerëzore, mënyra e plotësimit të 28 pozicioneve të punës në administratën e KMD, që janë pjesë e shërbimit civil në momentin e realizimit të mbikëqyrjes dhe pjesa që zënë në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, paraqitet si më poshtë:

- **11 pozicione pune**, që zënë rreth **39 %** të vendeve të punës në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, janë të plotësuara nga nëpunës, të cilët data 26.2.2014, që është edhe momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, i ka gjetur në pozicione pune pjesë e shërbimit civil.

Konstatohet se,

- në **10** raste, kohëzgjatja e periudhës së punësimit në të njëjtin vend pune, ka qenë më e madhe se 1 vit;
- në **1** rast, kohëzgjatja e periudhës së punësimit në të njëjtin vend pune, ka qenë më e vogël se 1 vit.

- **12 pozicione pune**, që zënë rreth **43 %** të vendeve të punës në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, janë plotësuar nëpërmjet konkurrimit për pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive, në përputhje me procedurat e përcaktuara nga ligji nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.
- **3 pozicione pune**, që zënë rreth **11 %** të vendeve të punës në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, janë plotësuar nga nëpunës civil ekzistues, të cilët, në pozicionin aktual, janë emëruar me ngritje në detyrë duke zbatuar procedurat e konkurrimit të përcaktuara nga neni 26, i ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe Vendimi nr. 242, datë 18.3.2015, i Këshillit të Ministrave, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”.
- **2 pozicione pune**, që zënë rreth **7 %** të vendeve të punës në raport me numrin e përgjithshëm të pozicioneve të punës pjesë e shërbimit civil, janë plotësuar nëpërmjet konkurrimit me kandidatë nga jashtë, në përputhje me pikën 4, të nenit 26, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.

II. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, gjatë aplikimit në praktikë të procesit të pranimit në shërbimin civil dhe zhvillimit të sistemit të karrierës nëpërmjet lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë.

Në zbatim të programit të mbikëqyrjes, grupi i punës, ka këqyru procedurat e konkurrimit për pranimin në shërbimin civil në nivelin ekzekutiv, të lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit nga jashtë shërbimit civil, në nivelin e ulët dhe të mesëm drejtues, në institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për periudhën mbas fillimit të efekteve juridike të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, deri në momentin e mbikëqyrjes (*Janar 2015 – maj 2021*).

1. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil.

Në zbatim të detyrimeve të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ku përcaktohet se; “.....dhe çdo institucion i pavarur, jo më vonë se muaji shkurt, miratojnë planet e veta të pranimeve vjetore.....”, institucioni duhet të miratojë planin vjetor të pranimit në pozicionet e lira pjesë e shërbimit civil në bazë të të cilave administrohet i gjithë procesi i rekrutimit.

Përgatitja e tij në mënyrë të detajuar dhe në përputhje me kërkesat ligjore, përbën një garanci për zhvillimin e gjithë procedurave të konkurrimit.

Nga dokumentacioni i këqyrrur për periudhën objekt mbikëqyrjeje, në lidhje me miratimin e këtij plani, rezulton si më poshtë:

➤ Plani i Pranimit në Shërbimin Civil viti 2015.

Me aktin nr. 21, datë 11.03.2015, të Komisionerit, “*Miratimi i Planit Vjetor për Pranimin në institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, pjesë e shërbimit civil për vitin 2015*”, është miratuar plani i rekrutimit në të cilin janë përfshirë 3 pozicione të lira në shërbimin civil, për tu plotësuar për vitin 2015, të paraqitura si më poshtë vijon:

- Pozicioni “*Drejtor Drejtorie*”, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse, 1 vend vakant, kategoria niveli i mesëm drejtues.
- Pozicioni “*Drejtor Drejtorie*”, në Drejtorinë e Procedurave Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, 1 vend vakant, kategoria niveli i mesëm drejtues.
- Pozicioni “*Specialist*”, në Drejtorinë e Procedurave Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, 1 vend vakant, nivel ekzekutiv.

Konstatohet se, pozicioni, “Specialist”, në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun, nuk ka qenë i përfshirë në Planin Vjetor të Rekrutimit për 2015, të miratuar nga institucioni, duke qënë se nuk ka qenë vend i lirë.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga institucioni i mbikëqyrrur, rezulton që ky pozicion mbeti i lirë pas lirimit nga detyra me dorëheqje të nëpunësit që kryente këtë detyrë. Për sa më sipër, pozicionin, “*Specialist*”, në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun, njësia përgjegjëse e institucionit Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, e ka përfshirë në shkresën për shpallje të pozicioneve të lira, drejtuar portalit vende të lira në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, (*shkresa nr. 236/1 prot., datë 12.03.2015*).

➤ Plani i Pranimit në Shërbimin Civil viti 2016

Nga verifikimi i listprezencave listpagesave dhe strukturës së institucionit për vitin 2016, rezulton se pozicioni i nivelit të mesëm drejtues, “*Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse*”, vazhdon të jetë pozicion i lirë. (*procedura e konkurrimit e kryer në vitin 2015, nuk u realizua, pasi nuk pati konkurrentë*). Pavarësisht këtij fakti, institucioni nuk ka hartuar planin e pranimeve në shërbimin civil, si dhe nuk ka zhvilluar asnjë procedurë konkurrimi për këtë vit.

➤ Plani i Pranimi në Shërbimin Civil viti 2017.

Për vitin 2017, institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nuk e ka hartuar Planin e Pranimeve në shërbimin civil, megjithëse pozicioni, “*Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse*”, vazhdonte të ishte i lirë.

Përgjatë këtij viti, është krijuar edhe një vend i lirë, pozicioni i nivelit ekzekutiv “*Specialist i Marrëdhënieve me Publikun*”, pas dorëheqjes së nëpunësit që kryente këtë detyrë.

Pavarësisht se nuk ishte miratuar plani i nevojave për rekrutim në shërbimin civil për këtë vit, institucioni, nëpërmjet e-mailit të datës 28.9.2017, drejtuar Shërbimit Kombëtar të Punësimit, ka kërkuar publikimin e dy pozicioneve të lira pjesë e shërbimit civil, në institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që janë:

- Pozicioni, “*Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse*”,
- Pozicioni, “*Specialist i Marrëdhënieve me Publikun*”, në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun

➤ Plani i Pranimi në Shërbimin Civil viti 2018.

Për vitin 2018, institucioni me aktin nr. 666 prot., datë 16.5.2018, ka miratuar “*Planin e pranimeve në shërbimin civil për vitin 2018*”, duke parashikuar zhvillimin e procedurës së konkurrimit për dy pozicione pune në shërbimin civil, konkretisht bëhet fjalë për pozicionet:

- “*Specialist*”, në Drejtorinë e Çështjeve Procedurale, Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, (*pozicioni specialist i marrëdhënieve me jashtë, niveli ekzekutiv, kategoria e pagës III-b*)
- “*Specialist*”, në Drejtorinë e Çështjeve Procedurale, Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, (*pozicion specialist jurist, niveli ekzekutiv, kategoria e pagës III-b*)

Këto pozicione mbetën të lira pasi 1 nëpunëse kaloi në detyrën Drejtore në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse, në përfundim të procedurës së konkurrimit ngritje në detyrë (*****, akti nr. 167, datë 14.11.2017) dhe 1 pozicion pas lirimit nga detyra të nëpunësit me dorëheqje (A. Çoku, akti nr. 33, datë 19.2.2018).

➤ Plani i Pranimi në Shërbimin Civil viti 2019.

Sipas dokumentacionit të këqyrrur, rezulton se, pas miratimit të strukturës së re me aktin nr.88/2018, të Kuvendit të Shqipërisë, institucioni ka pësuar ndryshime në rritje të numrit të pozicioneve në shërbimin civil, duke e çuar atë nga 18 në 28 pozicione. Si rezultat i këtij ristrukturimi, KMD, ka miratuar Planin Vjetor të Pranimi në Shërbimin Civil, me aktin

nr.95, datë 21.1.2019, “Mbi miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për vitin 2019”, në të cilin janë përfshirë **10** pozicione të lira në shërbimin civil, të paraqitura si më poshtë vijon:

- Drejtor Drejtorie (2), niveli i mesëm drejtues, kategoria e pagës II b.
- Inspektor (1), nivel ekzekutiv, kategoria e pagës III-b.
- Specialist (3), nivel ekzekutiv, kategoria e pagës III-b.
- Specialist (4), niveli ekzekutiv, kategoria e pagës IV-a.

Gjithashtu, në këtë akt, në mbështetje të pikës 4, të nenit 26, të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, është parashikuar që procedura e plotësimit të vendeve të lira për kategorinë e mesme drejtuese të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin/vendet e lira (*pranim nga jashtë shërbimit civil*).

➤ Plani i Pranimit në Shërbimin Civil viti 2020.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi për vitin 2020, ka miratuar Planin Vjetor të Pranimit në Shërbimin Civil, me aktin nr. 354/1 prot., datë 28.2.2020, “Mbi miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për vitin 2020”, në të cilin është përfshirë **1** pozicioni i lirë, niveli ekzekutiv, për tu plotësuar për vitin 2020, bëhet fjalë për pozicionin:

- Specialist (1), nivel ekzekutiv, kategoria e pagës III-b (Drejtorja Juridike)

➤ Plani i Pranimit në Shërbimin Civil viti 2021

Për vitin 2021, institucioni nuk ka hartuar planin e nevojave për rekrutim në shërbimin civil, pasi, deri në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes, pretendohet se nuk ka pozicione të lira. Nga verifikimi i listprezencave, listpagesave dhe strukturës së institucionit për vitin 2021, rezulton se pozicioni, “Specialist në Drejtorinë Juridike”, është vend i lirë.

Nëpunësja civile, që kryen këtë detyrë është pezulluar nga detyra, me kërkesën e saj për një periudhë 2 (dy) vjeçare, për shkak të emërimit në detyrën “Këshilltare”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me aktin nr. 234, datë 26.12.2019, të Komisionerit, “Për emërim në detyrë të *****”.

Nga sa më sipër, për periudhën objekt mbikëqyrje, Janar 2015 – Qershor 2021, institucioni ka planifikuar **19** pozicione të lira për rekrutim, të ndara sipas kategorive si më mëposhtë:

Tabela nr. 1 Pozicionet e shërbimit civil, të shpalluara për tu plotësuar gjatë periudhës Janar 2015- Qershor 2021.

Kategoria e pozicioneve në sh. c	Numri i pozicioneve
Për kategorinë e mesme drejtuese	5 pozicione
Për kategorinë e ulët drejtuese	1 pozicion
Për kategorinë ekzekutive	13 pozicione

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në zbatim të nenit 22, 25, 26, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe në zbatim të planeve të rekrutimit për secilin vit, ka organizuar konkurrimet për plotësimin e pozicioneve të lira të nivelit ekzekutiv, të ulët dhe të mesëm drejtues, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit në shërbimin civil.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit mbikëqyrës, rezulton se gjatë vitit 2015, është zhvilluar edhe një procedurë pranim në shërbimin civil për pozicionin *“Specialist i burimeve njerëzore”*.

Kjo vakancë u krijua pas lirimit nga detyra të punonjësës që mbante këtë pozicion dhe emërimit të saj në pozicionin *“Specialist”*, në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele.

Pra gjatë periudhës Janar 2015 – Qershor 2021, KMD, ka realizuar 20 procedura konkurrimi, të cilat janë publikuar në faqen zyrtare të institucionit, pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit, si dhe në stendën e institucionit dhe kanë përfunduar brenda afateve që përcakton legjislacioni për shërbimin civil.

Konkluzion: Në lidhje me sa më sipër, Komisioneri sjell në vëmendje të njësisë së burimeve njerëzore të institucionit, se duhet të tregojë kujdes në përgatitjen e planit të nevojave për rekrutim, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”*.

Edhe në rastet e lindjes së nevojës së zhvillimit të procedurave të konkurrimit për pozicione të krijuara të lira pas miratimit të planit vjetor të rekrutimit, si rrjedhojë e dorëheqjes, pezullimit (*për një afat më të gjatë se 3 muaj*) apo lirimit nga shërbimi civil, sipas shkaqeve të parashikuara në ligj, njësia përgjegjëse e institucionit, duhet të marrë masa për reflektimin

e vakancës nëpërmjet ndryshimit të planit vjetor sipas kërkesave të akteve përkatëse nënligjore.

I. Plotësimi i pozicioneve të lira në shërbimin civil në nivelin ekzekutiv, nivelin e ulët dhe të mesëm drejtues nëpërmjet konkurrimit dhe si janë respektuar kërkesat e nenit 22, 25, 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në lidhje me dy fazat e këtij procesi:

Bazuar në Kreun IV dhe V, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pozicionet e lira pjesë e shërbimit civil, plotësohen vetëm nëpërmjet procedurave të konkurrimit.

Për sa më sipër, grupi i punës verifikoi emërimet në pozicionet e shërbimit civil nëpërmjet procedurave të konkurrimit të hapur, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë të kryera nga viti 2015, deri në momentin e mbikëqyrjes.

Gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit (janar 2015 – qershor 2021), vërehet se në përgjithësi, nga njësia përgjegjëse është përmbushur detyrimi për të publikuar:

- aktin e shpalljes së konkurrimit,
- aktin e verifikimit paraprak e përfundimtar dhe
- publikimi i listës përfundimtare të kandidatëve fitues,

që është një kusht procedural që përcaktohet në dispozitat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar; Vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”; Vendimin nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”.

Respektimi i kësaj procedure është një tregues real i transparencës së konkurrimeve, pasi i krijon mundësinë kandidatëve, apo çdo shtetasi të interesuar, të njihet me shpalljen për një pozicion vakant në administratën publike, të njihet me kandidatët që do marrin pjesë në konkurrim dhe të njihet me fituesit në këtë proces. Gjithashtu, respektimi i kësaj procedure garanton zbatimin e parimeve të shanseve të barabarta dhe transparencës, të përcaktuar në nenin 5, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Nga këqyrja e dokumentacionit të hartuar në të gjitha konkurrimet e realizuara në institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, u vërejt se njësia përgjegjëse e institucionit ka vepruar si më poshtë:

- ✓ Ka bërë publike në faqen zyrtare të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, në rubrikën “*vende vakante*”, njoftimin për shpalljen e vendeve të lira duke pasqyruar në përmbaje të gjithë informacionin e parashikuar nga legjislacioni specifik që rregullon këtë aspekt.
- ✓ Në përfundim të fazës së verifikimit paraprak, në të gjitha rastet njësia përgjegjëse ka bërë publike në faqen zyrtare të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, në rubrikën “*vende vakante*”, listën e kandidatëve që plotësojnë këto kritere, duke i renditur ata sipas rendit alfabetik (në rastet kur ka më shumë se një aplikant), në përputhje me legjislacionin specifik që rregullon këtë aspekt;
- ✓ Në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve nga komisionet përkatëse, në të gjitha rastet njësia përgjegjëse ka bërë publike në faqen zyrtare të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, në rubrikën “*vende vakante*”, listën e kandidatëve fitues (*listën e kandidatëve fitues në përfundim të konkurrimit dhe listën përfundimtare të kandidatëve fitues, mbas ankesës në rastin kur kishte të tillë*), në përputhje me legjislacionin specifik që rregullon këtë aspekt.

Për një analizë sa më të plotë të procesit të konkurrimeve, ato i grupojmë në procedura që materializojnë:

- a) Lëvizjen paralele dhe pranimin në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive dhe
- b) Lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë për nivelin e ulët dhe të mesëm drejtues. (*Pozicione të nivelit të lartë drejtues në këtë institucion nuk ka*).

a) Lëvizja paralele dhe pranimi në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive

Në nenet 22, 23 dhe 25, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar si dhe në Vendimin nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, përcaktohen rregullat procedurale të konkurrimit, për plotësimin e pozicioneve të punës në nivelin ekzekutiv.

Sipas dispozitave të mësipërme ligjore, plotësimi i vendeve të lira në kategorinë ekzekutive, bëhet së pari, nga nëpunësit civil të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele. Nëse pozicionet e lira në një procedurë konkurrimi në kategorinë ekzekutive plotësohen me anën e procedurës së lëvizjes paralele, njësia përgjegjëse e institucionit shpall konkursin e mbyllur, duke bërë edhe njoftimin përkatës. Ndërsa, në rast se, mbeten pozicione të lira pas aplikimit të procedurës së lëvizjes paralele, atëherë njësia përgjegjëse i plotëson ato me anën e procedurave për pranimin në kategorinë ekzekutive.

Në zbatim të dispozitave ligjore si më sipër, njësia përgjegjëse e institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për periudhën Janar 2015- Qershor 2021, për plotësimin e pozicioneve të lira në nivelin ekzekutiv ka realizuar 14 procedura konkurrimi. Nga analiza e të dhënave të grumbulluara gjatë procesit të mbikëqyrjes, rezulton se:

- 1 pozicion i kategorisë ekzekutive është plotësuar nëpërmjet procedurës lëvizje paralele, brenda institucionit:
 1. *****, me aktin nr. 51, datë 21.04.2015, emërohet nëpunës civil, në pozicionin, “*Specialist i Marrëdhënieve me Publikun*”, në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele.
- 13 pozicione të kategorisë ekzekutive, janë plotësuar nëpërmjet procedurës së konkurrimit të hapur.

Për këto procedura të realizuara nëpërmjet konkurrimit të hapur, në zbatim të nenit 22, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, njësia përgjegjëse, ka nxjerrë aktet e emërimit nëpunës civilë në periudhë prove, në pozicionet si më poshtë:

1. *****, me aktin nr. 73, datë 18.05.2015, emërohet nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin, “*Specialist*”, në Drejtorinë e Procedurave Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë.
2. *****, me aktin nr. 102, datë 16.06.2015, emërohet nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin, “*Specialist i Burimeve Njerëzore*”, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.
3. *****, me aktin nr. 166, datë 14.11.2017, emërohet nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin, “*Specialist i Marrëdhënieve me Publikun*”, në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun.
4. *****, me aktin nr. 138, datë 12.07.2018, emërohet nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin, “*Specialist*”, në Drejtorinë e Çështjeve Procedurale, Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë.
5. *****, me aktin nr. 157, datë 31.08.2018, emërohet nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin, “*Specialist*”, në Drejtorinë e Çështjeve Procedurale, Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë.
6. *****, me aktin nr. 44, datë 13.03.2019, emërohet nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin, “*Specialist i Komunikimit me Mediat*”, në Drejtorinë e Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit.

7. *****, me aktin nr. 50, datë 26.03.2019, emërohet nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin, "*Specialist i pritjes së ankesave*", në Drejtorinë e Pritjes së Ankesave.
8. *****, me aktin nr. 51, datë 26.03.2019, emërohet nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin, "*Specialist i pritjes së ankesave*", në Zyrën e Pritjes së Ankesave Shkodër.
9. *****, me aktin nr. 52, datë 26.03.2019, emërohet nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin, "*Specialist i pritjes së ankesave*", në Zyrën e Pritjes së Ankesave Korçë.
10. *****, me aktin nr. 48, datë 21.03.2019, emërohet nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin, "*Specialist i Monitorimit dhe Raportimit*", në Drejtorinë e Monitorimit, Raportimit dhe Kontrollit.
11. *****, me aktin nr. 149, datë 30.08.2019, emërohet nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin, "*Specialist i Jetësimit të Projekteve*", në Drejtorinë e Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit.
12. *****, me aktin nr. 150 prot., datë 30.08.2019, emërohet nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin, "*Specialist i pritjes së ankesave*", në Zyrën e Pritjes së Ankesave Fier.
13. *****, me aktin nr. 111, datë 30.09.2020, emërohet nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin, "*Specialist*", në Drejtorinë Juridike.

Gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit në nivelin ekzekutiv, njësia përgjegjëse ka vepruar si më poshtë:

- ✓ Në të gjitha rastet, ka bërë shpalljen e procedurës së pranimit në portalin "*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*", si dhe në *Faqen Zyrtare*, të KMD, duke përcaktuar pozicionet e lira të punës, për të cilin do të zhvillohet konkurrimi; përshkrimin përgjithësues të pozicionit të punës; kriteret e përgjithshme; kërkesat specifike të pranimit në shërbimin civil (*arsimi i lartë përkatës*); dokumentacionin që do të paraqitet; datën për paraqitjen e aplikimit; datën e zhvillimit të konkurrimit; datën për shpalljen e rezultateve pas verifikimit paraprak; mënyrën e vlerësimit dhe njohuritë, aftësitë apo cilësitë që do të vlerësohen në konkurrim.
- ✓ Me urdhër të titullarit të institucionit (për vitet respektive kur është zhvilluar procedura e konkurrimit), është krijuar *Komiteti i Përhershëm i Pranimit në Kategorinë Ekzekutive KPP*.
Në të gjitha rastet ky organ ka në përbërjen e vet 3 përfaqësues të institucionit dhe 2 ekspertë të jashtëm të fushës së vlerësimit të pozicionit që zhvillohet procedura konkurruese.

- ✓ Pas verifikimit paraprak nga njësia përgjegjëse, lista me kandidatët e kualifikuar është shpallur në portalin “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*”, si dhe në *Faqen Zyrtare* të KMD.
- ✓ Kandidatët e kualifikuar, i janë nënshtruar testimit me shkrim dhe intervistës së strukturuar me gojë. Rezulton që në shumicën e rasteve është nënshkruar nga konkurrentët deklaratat e pranimit ose jo të regjistrimit me zë të intervistës me gojë. Në përfundim të vlerësimit, Komiteti i Përhershëm i Pranimit, i ka renditur kandidatët fitues në një listë, duke filluar nga kandidati me rezultate më të larta (*më shumë se 70% të pikëve*).
- ✓ Pasi është shpallur lista e fituesve, në portalin “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*” dhe në *Faqen Zyrtare* të KMD, njësia përgjegjëse, ka nxjerrë aktin e emërimit, duke i deklaruar *nëpunës civilë në periudhë prove* në pozicionet përkatëse.

Në vijim të analizës së procedurave të konkurrimit, rezulton se, njësia përgjegjëse e institucionit, **për të gjitha pozicionet e nivelit ekzekutiv ka zhvilluar konkurrime individuale, si dhe numri i kandidatëve që kanë aplikuar në shumicën e konkurrimeve ka qenë 1 (një)**.

Më tej, rezulton se nga KPP, është hartuar Teza e provimit me shkrim (*me shtjellim*) që rezulton të jetë brenda fushës testimit të publikuar, si dhe bashkëlidhur ka çelësin e përgjigjeve. Gjithë dokumentacioni është i nënshkruar nga anëtarët e KPP.

Nga publikimi i akteve në përfundim të procedurës së konkurrimit, rezulton se njësia përgjegjëse, ka marrë në shqyrtim ankesat e paraqitura nga kandidatët konkurrent, fakt ky që materializohet në përgjigjet e kthjera ankuesit, nëpërmjet e-mailit. Rezulton se ka pasur vetëm një ankesë, e cila i përket procedurës së konkurrimit “*Specialist i Monitorimit dhe Raportimit*”, në *Drejtorinë e Monitorimit, Raportimit dhe Kontrollit* – procesverbali përkatës.

Më tej, në vazhdim të këqyrjes së akteve të shpalljes, konstatohet fakti se në disa raste, pozicioni i punës për të cilin është zhvilluar procedura e konkurrimit, ka pasur të njëjtën emërtesë, ka qenë pjesë e të njëjtës njësi organizative (*drejtori*) dhe ka pasur të njëjtat kriteret të posaçme, por njësia përgjegjëse e institucionit ka vijuar duke zhvilluar 3 (tre) procedura individuale për secilin prej tyre, duke mos realizuar në këtë rast procedurën e rekrutimit me grup pozicionesh.

Konkretisht, përmendim shpalljet për pozicionet, “*Specialist i pritjes së ankesave*”, nga ku rezulton se 3 (tre) procedurat e konkurrimit janë kryer për të njëjtin pozicion, me emërtesën “*Specialist*”, në *Drejtorinë e Pritjes së Ankesave, (Zyra e Pritjes së Ankesave Korçë; Zyra*

e Pritjes së Ankesave Fier, Zyra e Pritjes së Ankesave Shkodër), për të cilat kërkesat e posaçme të pozicionit të punës janë të njëjta, duke mos realizuar procedurën e rekrutimit me grup pozicionesh.

Në vazhdim, nga këqyrja e akteve konstatohet se:

- në procedurat e konkurrimit, megjithëse janë mbajtur aktet për të gjitha fazat e procesit, një pjesë e tyre nuk kanë të identifikuar datën e hartimit të tyre,
- Deklarata për vlerësimin e paanshmërisë së anëtarëve të Komitetit është e nënshkruar nga të gjithë anëtarët në një format të vetëm, dhe jo individualisht, si dhe
- në procedurat me më shumë se një kandidat, procesverbali i vlerësimit është i përbashkët për të gjithë kandidatët dhe jo individual sipas kërkesave në aktet ligjore e nënligjore të shërbimit civil.

Konkluzion: Nga sa analizuam më sipër, vlerësohet se, janë bërë përpjekje që procedurat e rekrutimit, nëpërmjet lëvizjes paralele dhe konkurrimit të hapur për **14** pozicione të kategorisë ekzekutive, të kryhen sipas kërkesave të përcaktuara në ligjin nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.

Ndërkohë, rezulton se, gjatë realizimit të procedurave të konkurrimit në zbatim të planit vjetor të rekrutimit për vitet respektive janë konstatuar parregullsi të cilat paraqiten në vijim:

1. Organizimi i procedurave të konkurrimit për pozicionet e nivelit ekzekutiv, duhet që këto procedura, të realizohen sipas parimeve të përcaktuara në legjislacionin për shërbimin civil, sipas grupeve të administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm, me qëllim garantimin e një procesi përzgjedhës transparent, të drejtë dhe objektiv të nëpunësve civilë.
2. Plotësimi i dokumentacionit sipas përcaktimeve ligjore, siç është folur më sipër në material, me qëllim kryerjen në mënyrë sa më efektive të procedurave të konkurrimit.

Duke analizuar të dhënat e administruara nga dosjet e konkurrimit dhe të publikuara në faqen zyrtare të portalit Shërbimi Kombëtar i Punësimit, këto procedura janë realizuar si më poshtë:

➤ **Procedura konkurrimi të realizuara në vitin 2015**

Për vitin 2015, institucioni ka planifikuar 2 procedura rekrutimi në nivelin ekzekutiv, përkatësisht:

- Pozicioni, “*Specialist*” në Drejtorinë e Procedurave Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë
- Pozicioni, “*Specialist*” në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun

Në përfundim të procedurës së konkurrimit për pozicionin “*Specialist i Marrëdhënieve me Publikun*”, rezulton fituese kandidatja *****, nëpunëse civile e konfirmuar në pozicionin “*Specialist i Burimeve Njerëzore*”, në institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Fakti që kjo nëpunëse u emërua në pozicionin, “*Specialist i Marrëdhënieve me Publikun*”, çoi në mbetjen vakant të pozicionit, “*Specialist i Burimeve Njerëzore*”. Për pasojë, ky pozicion është shpallur nga institucioni për tu plotësuar përmes procedurës së konkurrimit brenda vitit 2015.

Për gjithë sa më sipër, institucioni për vitin 2015, ka publikuar dhe ka realizuar 3 procedura konkurrimi në nivelin ekzekutiv, të cilat paraqiten të realizuara në këtë mënyrë:

1. Procedura e rekrutimit për pozicionin, “*Specialist*”, në Sektorin Marrëdhënieve me Publikun

- Në zbatim të planit të rekrutimit, institucioni me aktin nr. 236/1 prot., datë 12.03.2015, “*Kërkesë për shpalljen e vendeve të lira të punës në institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, bashkëlidhur “*Njoftim për vend të lirë pune*”, ka publikuar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, pozicionin, “*Specialist në Sektorin Marrëdhënieve me Publikun*”, niveli ekzekutiv, kategoria e pagës IV-a.
- Në këtë publikim është planifikuar lëvizje paralele dhe pranimi në shërbimin civil, duke përcaktuar afatin e dorëzimit të dokumentacionit të njëjtë për të dy procedurat. Pas publikimit të bërë në faqen zyrtare të institucionit, Shërbimin Kombëtar të Punësimit dhe stendën e institucionit, procedura vazhdoi me verifikimin e kandidatëve që plotësonin kushtet për vazhdimin e fazave të mëtejshme të konkurrimit. Në përfundim të verifikimit për lëvizje paralele, rezultoi që kandidatja ***** plotësonte kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të shpallura për këtë pozicion pune. (Publikuar në SHKP, me aktin nr. 340 prot., datë 10.4.2015)
- Me aktin nr. 340 prot., datë 10.4.2015, është bërë publikimi në Shërbimin Kombëtar të Punësimit dhe për këtë pozicion pune, është paraqitur 1 kandidatë. Kandidatja ***** kualifikohet për të vazhduar fazën e dytë të konkurrimit, pasi plotëson kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të publikuara në shpallje, për lëvizje paralele për pozicionin, “*Specialist i Burimeve Njerëzore*”, në institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Në përfundim të zhvillimit të të gjithë fazave të konkurrimit, (*vlerësimi të jetëshkrimi intervistës së strukturuar me gojë*), me Memon e hartuar nga KPLP, është njoftuar, njësia përgjegjëse dhe titullari i institucionit për përfundimin e procedurës së

konkurrimit për pozicionin “*Specialist*”, në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun dhe shpalljen fitues të kandidatës *****.

2. Procedura e rekrutimit për pozicionin, “*Specialist*”, në Drejtorinë e Procedurave Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë

- Në vazhdim të zbatimit të planit të rekrutimit, institucioni me aktin nr. 236/1 prot., datë 12.03.2015, “*Kërkesë për shpalljen e vendeve të lira të punës në institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, bashkëlidhur “*Njoftim për vend të lirë pune*”, ka publikuar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, pozicionin “*Specialist*”, në Drejtorinë e Procedurave Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, niveli ekzekutiv, kategoria e pagës III-b. Në këtë publikim është planifikuar lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil, duke përcaktuar afatin e dorëzimit të dokumentacionit të njëjtë për të dy procedurat, datë (08.04.2015).
- Në përmbajtje të këtij publikimi, është përfshirë përkrahimi i përgjithshëm i pozicionit të punës; kushtet për lëvizjen paralele/ pranim nga jashtë shërbimit civil, si dhe kriteret e posaçme që duhet të plotësojë kandidati për këtë pozicion pune. Gjithashtu, fusha e njohurive mbi të cilat do të zhvillohet testimi.
- Nga dokumentacioni i shqyrtuar, rezulton se janë respektuar afatet e dorëzimit të dokumentacionit (08.04.2015), si dhe afati i parashikuar për verifikimin paraprak të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët, (10.04.2015).
- Për këtë procedurë konkurrimi ka funksionuar Komiteti i Përhershëm i Pranimit, i ngritur me Urdhrin nr. 58, datë 07.05.2015, “*Për ngritjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimit për kategorinë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese*”, në përbërjen me pesë anëtarë.
- Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga anëtarët e Komitetit të Pranimit është nënshkruar “*Deklarata për vlerësimin e paanshmërisë së anëtarëve të Komitetit të Pranimit*”, në një akt të vetëm.
- Referuar “*Listës së vlerësimit paraprak të kandidatëve të kualifikuar*”, për të vazhduar me fazën e dytë të konkurrimit për vendin e lirë të punës “*Specialist*”, në Drejtorinë e Procedurave Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të përpiluar nga njësia përgjegjëse, rezulton se, procedura për lëvizje paralele nuk ka patur kandidatë.
- Në procedurën e pranimit në shërbimin civil, ka patur tre kandidatura, ku një kandidate ***** është skualifikuar për shkak se nuk plotësonte vjetërsinë në punë (1 vit),

ndërsa dy kandidatet e kualifikuara për fazat e mëtejshme të konkurrimit janë ***** dhe *****). Ky njoftim me rezultatin e verifikimi paraprak është publikuar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, me aktin nr. 340/1 prot., datë 17.04.2015, ku është saktësuar data 12.05.2015, ora 11.00, dhe vendi i zhvillimit të testimit me shkrim, Godina e Komisionerit. Në këtë akt janë parashikuar edhe afatet e ankimit të vendimeve, për kandidatët e skualifikuar.

- Nga verifikimi i dosjes personale të kandidatës *****, gjendet dokumentacioni i plotë, i cili vërteton se kjo candidate plotëson kriteret e posaçme të vendosura për pozicionin e shpallur.
- Nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit është përpiluar teza e provimit me shkrim, e cila bashkëlidhur ka edhe çelësin e përgjigjeve. Gjithashtu, përpara zhvillimit të testimit me shkrim, është mbajtur procesverbal prezence i kandidatëve të kualifikuar për këtë fazë, datë 12.05.2015, ku është konstatuar se kandidatja e dytë e kualifikuar *****, nuk është paraqitur në testimin me shkrim.
- KPP ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit me shkrim të konkurrentes, ku janë pasqyruar pikët e marra për secilën pyetje, si dhe shuma në total e pikëve 51 pikë. (një pasqyrë).
- KPP ka kryer vlerësimin e jetëshkrimit të konkurrentes sipas procesverbalit të mbajtur datë 12.05.2015, në total 12 pikë.
- KPP ka hartuar listën e pyetjeve për intervistën e strukturuar me gojë, dhe është mbajtur procesverbali i vlerësimit të konkurrentes për këtë fazë konkurrimi, gjithsej 13 pikë.
- Në përfundim të zhvillimit të të gjithë fazave të konkurrimit, është mbajtur procesverbali i vlerësimit përfundimtar të konkurrentes, si dhe procesverbali i renditjes me pikë të kandidatëve në përfundim të vlerësimit, i cili ka rezultuar 76 pikë.
- Memo e hartuar nga KPP, datë 12.05.2015, drejtuar titullarit të institucionit për përfundimin e konkurrimit për pozicionin e punës “*Specialist*”, në Drejtorinë e Procedurave Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, dhe shpalljen fitues të kandidatës *****.
- Me aktin nr. 459 prot., datë 13.05.2015, është kryer publikimi i fituesit në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, për pozicionin “*Specialist*”, në Drejtorinë e Procedurave Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

- Me aktin nr. 460 prot., datë 13.05.2015, njësia përgjegjëse ka njoftuar titullarin për përfundimin e fazës së dytë të konkurrimit dhe shpalljen e fituesit, ******, për pozicionin “*Specialiste*”, në Drejtorinë e Procedurave Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në institucionin Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Me aktin nr. 73, datë 18.05.2015, “*Për emërimin në detyrë të *******”, është emëruar në pozicionin “*Specialiste*”, në Drejtorinë e Procedurave Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në periudhë prove.

3. Procedura e rekrutimit për pozicionin “*Specialist i Burimeve Njerëzore*”, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.

- Në vazhdim të plotësimit të planit për plotësimin e pozicioneve të lira për vitin 2015, institucioni me aktin nr. 415 prot., datë 04.05.2015, bashkëlidhur “*Shpallje për lëvizje paralele, pranim në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive*”, ka publikuar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, pozicionin “*Specialist i Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse*”, kategoria ekzekutive, niveli i pagës IV-a. Në këtë publikim është planifikuar lëvizje paralele dhe pranimi në shërbimin civil, duke përcaktuar dorëzimin e dokumentacionit për procedurën e lëvizjes paralele, datë 15.05.2015 dhe pranimit në shërbimin civil, datë 20.05.2015.
- Në përmbajtje të këtij publikimi, është përfshirë përshkrimi i përgjithshëm i pozicionit të punës; kushtet për lëvizjen paralele/ ngritje në detyrë/ pranim në shërbimin civil, si dhe kriteret e posaçme që duhet të plotësojë kandidati për këtë pozicion pune. Gjithashtu, fusha e njohurive mbi të cilat do të zhvillohet testimi.
- Nga dokumentacioni i shqyrtuar, rezulton se, janë respektuar afatet e dorëzimit të tij, si dhe afati i parashikuar për verifikimin paraprak të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët, (18.05.2015) për lëvizjen paralele dhe (22.05.2015) për pranim në shërbimin civil.
- Referuar “*Listës së vlerësimit paraprak të kandidatëve të kualifikuar*”, për të vazhduar me fazën e dytë të konkurrimit për vendin e lirë të punës “*Specialist i Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse*”, të përpiluar nga njësia përgjegjëse, rezulton se, procedura për lëvizje paralele nuk ka patur kandidatë, akti nr.499 prot., datë 20.05.2015.
- Në procedurën e pranimit në shërbimin civil, ka patur një kandidat dhe njoftimi për rezultatin e verifikimit paraprak është publikuar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, me aktin nr. 510 prot., datë 22.05.2015, ku është saktësuar data dhe vendi i zhvillimit të

testimit me shkrim (09.06.2015, ora 10.00), si dhe testimi me gojë datë 09.06.2015, ambjentet e KMD.

- Nga verifikimi i dosjes personale të kandidatit të kualifikuar rezulton se, dokumentacioni i dorëzuar është i plotë.
- Me Urdhrin nr. 96, datë 05.06.2015, “*Për ngritjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimit në nivelin ekzekutiv KPP*”, është ngritur KPP në përbërje me pesë anëtarë, dy prej të cilëve janë ekspert të jashtëm, dhe tre përfaqësues të institucionit, të cilët 2 mbajnë pozicione të nivelit ekzekutiv dhe 1 niveli i ulët drejtues.
- Nga përmbajtja e Urdhrit për ngritjen e KPP-së, vihet re se, baza ligjore mbi të cilin është ngritur ky Komitet është në mbështetje të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave.
- Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga anëtarët e KPP-së është nënshkruar “*Deklarata për vlerësimin e paanshmërisë së anëtarëve të Komitetit të Përhershëm të Pranimit*”, në një akt të vetëm, datë 09.06.2015.
- Nga KPP-ja është përpiluar Teza e provimit me shkrim dhe i bashkëlidhet çelësi i përgjigjeve. Gjithashtu, përpara zhvillimit të testimit me shkrim, është mbajtur procesverbal prezence i kandidatëve të kualifikuar për këtë fazë, datë 09.06.2015.
- KPP ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit me shkrim të kandidatit, ku janë pasqyruar pikët e marra për secilën pyetje, si dhe shuma në total e pikëve (një pasqyrë).
- KPP ka kryer vlerësimin e jetëshkrimit të konkurrentit sipas procesverbalit të mbajtur, datë 09.06.2015.
- **Në dosjen e dokumentacionit nuk gjendet “*Deklarata për regjistrimin me zë të intervistës së strukturuar me gojë*”.**
- KPP ka hartuar listën e pyetjeve për intervistën me gojë, dhe është mbajtur procesverbali i vlerësimit të konkurrentit për këtë fazë konkurrimi, datë 09.06.2015.
- Në përfundim të zhvillimit të të gjithë fazave të konkurrimit, është mbajtur procesverbali i vlerësimit përfundimtar të konkurrentit, si dhe procesverbali i renditjes me pikë të kandidatit në përfundim të vlerësimit, ku ka rezultuar fitues kandidati ***** me 76 pikë.

- Memo e hartuar nga KPP, datë 10.06.2015, drejtuar titullarit të institucionit për përfundimin e konkurrimit për pozicionin e punës “*Specialist i Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse*”, dhe shpalljen fitues të kandidatit *****.
- Me aktin nr. 576 prot., datë 10.06.2015, është kryer publikimi i fituesit në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, për pozicionin “*Specialist i Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse*”. Me aktin nr. 577 prot., datë 10.06.2015 është njoftuar titullari i institucionit dhe me aktin nr. 578 prot., datë 10.06.2015 është njoftuar Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, për rezultatin.
- Akti i emërimit për punonjësën është bërë me Urdhrin nr. 102, datë 16.06.2015, të Komisionerit, “*Për emërimin në detyrë të z. ******”.

➤ **Procedura konkurrimi të realizuara në vitin 2017**

Për vitin 2017, ashtu sikundër është përmendur edhe më sipër në material, institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nuk e ka hartuar planin e nevojave për rekrutim në shërbimin civil.

Pas miratimit të dorëheqjes dhe lirimit nga detyra, me aktin nr. 91, datë 24.7.2017, të punonjësës *****, pozicioni, “*Specialist i Marrëdhënieve me Publikun*”, ngelet pozicion i lirë.

Në vijim, për plotësimin e këtij pozicioni, institucioni realizoi procedurën konkurruese si më poshtë:

4. Procedura e rekrutimit për pozicionin, “*Specialist i Marrëdhënieve me Publikun*”

- Njësia përgjegjëse me shkresën nr. 940 prot., datë 28.09.2017, “*Dërgohet njoftim për shpalljen e dy pozicioneve të lira pjesë e shërbimit civil në institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, ka shpallur pozicionin e lirë “*Specialist i Marrëdhënieve me Publikun*”, në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun. Bashkëlidhur njoftimit gjendet “*Shpallje për lëvizje paralele/pranim në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive*”, publikuar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, për pozicionin “*Specialist i Marrëdhënieve me Publikun*”, niveli i pagës IV a.
- Në këtë publikim është planifikuar lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil, duke përcaktuar afatin e dorëzimit të dokumentacionit, për procedurën e lëvizjes paralele, data 09.10.2017 dhe për procedurën e pranimit në shërbimin civil, datë 14.10.2017.

- Në përmbajtje të këtij publikimi, është përfshirë përshtkrimi i përgjithshëm i pozicionit të punës; kushtet për lëvizjen paralele/pranim në shërbimin civil, si dhe kriteret e posaçme që duhet të plotësojë kandidati për këtë pozicion pune. Gjithashtu, fusha e njohurive mbi të cilat do të zhvillohet testimi.
- Nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se, janë respektuar afatet e dorëzimit të dokumentacionit, si dhe afati i parashikuar për verifikimin paraprak të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët, për lëvizjen paralele datë 12.10.2017 dhe pranim në shërbimin civil, datë 24.10.2017.
- Me aktin e verifikimit për procedurën e lëvizjes paralele datë 12.10.2017, *“Njoftim mbi rezultatet e verifikimit paraprak për lëvizjen paralele në kategorinë ekzekutive”*, njësia përgjegjëse ka publikuar në faqen zyrtare të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, njoftimin se, kjo procedurë është mbyllur pa kandidatë.
- Me aktin nr. 1037 prot., datë 24.10.2017, *“Dërgohet njoftim mbi verifikimin paraprak të aplikantëve për dy pozicione të lira pjesë e shërbimit civil, në institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminim”*, njësia përgjegjëse, ka publikuar në faqen zyrtare të SHKP njoftimin se dy kandidatët që kishin aplikuar për pozicionin, *“Specialist i Marrëdhënieve me Publikun”* dhe që plotësojnë kriteret për të vazhduar fazat e mëtejshme të konkurrimit, janë:
 - *****
 - *****
- Sipas publikimit të bërë, testimi me shkrim është zhvilluar në datë 06.11.2017, ora 10.00, ndërsa testimi me gojë është zhvilluar në datë 06.11.2017, ora 12.00, në ambjentet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Me Urdhrin nr. 157, datë 02.11.2017, (nr. 1076 prot., datë 02.11.2017), *“Për ngritjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimit për kategorinë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese (KPP)”* dhe aktin nr. 1078 prot., datë 02.11.2017, *“Caktimi i ekspertëve në komitetin e përhershëm të pranimit për nivelin ekzekutiv”*, është miratuar përbërja e Komitetit të Pranimit duke respektuar kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil.
- Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga anëtarët e KPP është nënshkruar *“Deklarata për vlerësimin e paanshmërisë së anëtarëve të Komitetit të Përhershëm të Pranimit”*, në një akt të vetëm.

- Nga verifikimi i dokumentacionit në dosjen personale të secilit kandidat, rezulton se, të dy kandidatët e paraqitur plotësojnë kriteret e posaçme të vendosura për pozicionin e shpallur.
- Sipas procesverbalit të mbajtur në datë 06.11.2017, “Konstatimi i situatave të veçanta për pozicionin”, nuk ka konstatime të tilla.
- Nga KPP është mbajtur procesverbali i konstatimit të prezencës datë 06.11.2017, ku janë paraqitur të dy kandidatët.
- Nga Komiteti i Përhershëm i Pranimi është përpiluar Teza e testimit me shkrim, e cila bashkëlidhur ka edhe çelësin e përgjigjeve. Gjithashtu, bashkëlidhur gjendet edhe teza e përgjigjeve të kandidatëve pjesëmarrës në këtë fazë konkurrimi, fusha e pyetjeve përputhet me kërkesat e pozicionit të punës.
- KPP ka hartuar raport për vlerësimin e kandidatëve, ku është pasqyruar vlerësimi për testimin me shkrim, si dhe vlerësimi për jetëshkrimin, dhe në fund të raportit jepet rezultatit përfundimtar për të dy kandidatët.
- Në dosjen e dokumentacionit gjendet “Deklarata për regjistrimin me zë të intervistës së strukturuar me gojë”, sipas së cilës, kandidatët nuk kanë preferuar të regjistrohen gjatë intervistës së strukturuar me gojë.
- KPP ka hartuar listën e pyetjeve për intervistën me gojë, dhe është mbajtur procesverbali i vlerësimit të konkurrentëve për këtë fazë konkurrimi.
- Në përfundim të zhvillimit të të gjithë fazave të konkurrimit, është mbajtur Proceverbali për renditjen më pikë të kandidatëve në përfundim të vlerësimit të tyre, datë 06.11.2017;
 - ***** , 74 pikë
 - ***** , 71 pikë
- Memo e datës 07.11.2017, e hartuar nga Kryetarja e KPP-së, drejtuar njësisë përgjegjëse, “Informacion mbi përfundimin e vlerësimit për pozicionin “Specialist në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun”, për përfundimin e konkurrimit dhe shpalljen fitues të kandidatit *****.
- Me aktin nr. 1119 prot., datë 14.11.2017, është kryer publikimi i fituesit në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, për pozicionin “Specialist i Marrëdhënieve me Publikun”, në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

- Me urdhrin nr. 166, datë 14.11.2017, “Për emërimin në detyrë të *****”, është emëruar në pozicionin “*Specialist i Marrëdhënieve me Publikun*”, në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun, në periudhë prove.

➤ **Procedura konkurrimi të realizuara në vitin 2018**

Në zbatim të planit të rekrutimit të miratuar, institucioni ka realizuar 2 procedura rekrutimi në nivelin ekzekutiv, që janë:

5. Procedura e rekrutimit për pozicionin “*Specialist në Drejtorinë e Çështjeve Procedurale Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë*”

- Në zbatim të planit të rekrutimit, akti nr. 665, datë 16.05.2018, “*Mbi publikimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil*”, institucioni me aktin nr. 787 prot., datë 31.05.2018, ka bashkëlidhur “*Shpallje për lëvizje paralele, pranim në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive*”, ka publikuar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, pozicionin, “*Specialist në Drejtorinë e Çështjeve Procedurale Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë*”, kategoria ekzekutive, niveli i pagës III-b. Në këtë publikim është planifikuar lëvizje paralele dhe pranimi në shërbimin civil, duke përcaktuar dorëzimin e dokumentacionit për procedurën e lëvizjes paralele, datë 10.06.2018 dhe pranimit në shërbimin civil, datë 15.06.2018.
- Në përmbajtje të këtij publikim, është përfshirë përshkrimi i përgjithshëm i pozicionit të punës; kushtet për lëvizjen paralele/ ngritje në detyrë/ pranim nga jashtë shërbimit civil, si dhe kriteret e posaçme që duhet të plotësojë kandidati për këtë pozicion pune. Gjithashtu, fusha e njohurive mbi të cilat do të zhvillohet testimi.
- Nga dokumentacioni i shqyrtuar, rezulton se, janë respektuar afatet e dorëzimit të dokumentacionit, si dhe afati i parashikuar për verifikimin paraprak të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët, (08.04.2018) për lëvizjen paralele dhe (12.06.2018) për pranim në shërbimin civil.
- Referuar “*Listës së vlerësimit paraprak të kandidatëve të kualifikuar*”, për të vazhduar me fazën e dytë të konkurrimit për vendin e lirë të punës, “*Specialist*”, në Drejtorinë e Çështjeve Procedurale Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të përpiluar nga njësia përgjegjëse, rezulton se, procedura për lëvizje paralele nuk ka patur kandidatë.
- Në procedurën e pranimit në shërbimin civil, ka patur pesë kandidatura, ku katër kandidatë janë skualifikuar për fazat e mëtejshme të konkurrimit, për shkak të

mosplotësimi të kritereve, eksperiencës në punë dhe nivelin përkatës të arsimit (konkurenti *****, zotëronte diplomë Bachelor). Njoftimi me rezultatin e verifikimi paraprak është publikuar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, me aktin nr.908 prot., datë 25.06.2018, ku është saktësuar data dhe vendi i zhvillimit të testimit me shkrim (09.07.2018, ora 10.00) dhe testimit me gojë (09.07.2018, ora 14.00). Në këtë akt janë parashikuar edhe afatet e ankimit të vendimeve, për kandidatët e s'kualifikuar.

- Nga verifikimi i dosjes personale të kandidatëve të kualifikuar rezulton se, dokumentacioni i dorëzuar është i plotë.
- Me Urdhrin nr. 133, datë 03.07.2018, *“Për ngritjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimi në nivelin ekzekutiv KPP”*, është ngritur Komiteti i Pranimi, në përbërjen me pesë anëtarë, dy prej të cilëve janë ekspert të jashtëm dhe tre përfaqësues të institucionit, të cilët mbajnë 3 pozicione të nivelit mesëm drejtues.
- Nga përmbajtja e Urdhrit për ngritjen e KPP-së, vihet re se, baza ligjore mbi të cilin është ngritur ky Komitet është në mbështetje të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave.
- Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga anëtarët e KPP-së është nënshkruar *“Deklarata për vlerësimin e paanshmërisë së anëtarëve të Komitetit të Përhershëm të Pranimi”*, në një akt të vetëm, datë 09.04.2018.
- Nga KPP-ja është përpiluar Teza e provimit me shkrim dhe i bashkëlidhet çelësi i përgjigjeve. Gjithashtu, përpara zhvillimit të testimit me shkrim, është mbajtur procesverbal prezence i kandidatëve të kualifikuar për këtë fazë, datë 09.07.2018.
- KPP ka mbajtur procesverbalin e datës 09.07.2018, *“Për konstatimin e situatave të veçanta”*, nuk ka rezultuar situatë e tillë.
- KPP ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit me shkrim të kandidatës, ku janë pasqyruar pikët e marra për secilën pyetje, si dhe shuma në total e pikëve (një pasqyrë).
- KPP ka kryer vlerësimin e jetëshkrimit të konkurrentëve sipas procesverbalit të mbajtur, datë 09.07.2018.
- Në dosjen e dokumentacionit mungon *“Deklarata për regjistrimin me zë të intervistës së strukturuar me gojë”*.

- KPP ka hartuar listën e pyetjeve për intervistën me gojë, dhe është mbajtur procesverbali i vlerësimit të konkurrentëve për këtë fazë konkurrimi, datë 09.07.2018.
- Në përfundim të zhvillimit të të gjithë fazave të konkurrimit, është mbajtur procesverbali i vlerësimit përfundimtar të konkurrentit, si dhe procesverbali i renditjes me pikë të kandidatës në përfundim të vlerësimit, ku ka rezultuar fituese kandidatja ***** me 76 pikë.
- Memo e hartuar nga KPP, datë 09.07.2018, drejtuar Titullarit të institucionit për përfundimin e konkurrimit për pozicionin e punës “*Specialist në Drejtorinë e Çështjeve Procedurale Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë*”, dhe shpalljen fitues të kandidatës *****.
- Me aktin nr. 972 prot., datë 10.07.2018, është kryer publikimi i fituesit në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, për pozicionin “*Specialist në Drejtorinë e Çështjeve Procedurale Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë*”.
- Akti i emërimit për punonjësen është bërë me Urdhrin nr. 138, datë 12.07.2018, të Komisionerit, “*Për emërimin në detyrë të znj. ******”.

6. Procedura e rekrutimit për pozicionin, “*Specialist, në Drejtorinë e Çështjeve Procedurale Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë*”.

- Në zbatim të planit të rekrutimit, institucioni me aktin nr. 1103 prot., datë 03.08.2018, bashkëlidhur “*Shpallje për lëvizje paralele, pranim në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive*”, ka publikuar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, pozicionin “*Specialist*”, në Drejtorinë e Çështjeve Procedurale Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, kategoria ekzekutive, niveli i pagës III-b. Në këtë publikim është planifikuar lëvizje paralele dhe pranimi në shërbimin civil, duke përcaktuar dorëzimin e dokumentacionit për procedurën e lëvizjes paralele, datë 12.08.2018 dhe pranimit në shërbimin civil, datë 17.08.2018.
- Në përmbajtje të këtij publikimi, është përfshirë përshkrimi i përgjithshëm i pozicionit të punës; kushtet për lëvizjen paralele/ ngritje në detyrë/ pranim nga jashtë shërbimit civil, si dhe kriteret e posaçme që duhet të plotësojë kandidati për këtë pozicion pune. Gjithashtu, fusha e njohurive mbi të cilat do të zhvillohet testimi.
- Nga dokumentacioni i shqyrtuar, rezulton se, janë respektuar afatet e dorëzimit të tij, si dhe afati i parashikuar për verifikimin paraprak të dokumentacionit të dorëzuar nga

kandidatët, (14.08.2018) për lëvizjen paralele dhe (27.08.2018) për pranim në shërbimin civil.

- Referuar “*Listës së vlerësimit paraprak të kandidatëve të kualifikuar*”, për të vazhduar me fazën e dytë të konkurrimit për vendin e lirë të punës “*Specialist*”, në Drejtorinë e Çështjeve Procedurale Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të përpiluar nga njësia përgjegjëse, rezulton se, procedura për lëvizje paralele nuk ka patur kandidatë, akti nr.1137 prot., datë 13.08.2018.
- Në procedurën e pranimit në shërbimin civil, ka patur një kandidat, njoftimi me rezultatin e verifikimi paraprak është publikuar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, me aktin nr. 1170 prot., datë 24.08.2018, ku është saktësuar data dhe vendi i zhvillimit të testimit me shkrim (29.08.2018, ora 10.00) dhe testimit me gojë (28.08.2018, ora 14.00).
- Nga verifikimi i dosjes personale të kandidates së kualifikuar rezulton se, dokumentacioni i dorëzuar është i plotë.
- Me Urdhrin nr. 133, datë 03.07.2018, “*Për ngritjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimit në nivelin ekzekutiv KPP*”, i ndryshuar me Urdhrin nr. 155, datë 24.08.2018, është ngritur Komiteti i Pranimit, në përbërje me pesë anëtarë, dy prej të cilëve janë ekspert të jashtëm, dhe tre përfaqësues të institucionit, të cilët mbajnë 2 pozicione të nivelit mesëm drejtues dhe 1 niveli i ulët drejtues.
- Nga përmbajtja e Urdhrit për ngritjen e KPP-së, vihet re se, baza ligjore mbi të cilin është ngritur ky Komitet është në mbështetje të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave.
- Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezulton se nga anëtarët e KPP-së është nënshkruar “*Deklarata për vlerësimin e paanshmërisë së anëtarëve të Komitetit të Përhershëm të Pranimit*”, në një akt të vetëm, datë 29.08.2018.
- Nga KPP-ja është përpiluar Teza e provimit me shkrim dhe i bashkëlidhet çelësi i përgjigjeve. Gjithashtu, përpara zhvillimit të testimit me shkrim, është mbajtur procesverbal prezence i kandidatëve të kualifikuar për këtë fazë, datë 29.08.2018.
- KPP ka mbajtur procesverbalin e datës 29.08.2018, “*Për konstatimin e situatave të veçanta*”, nuk ka rezultuar situatë e tillë.

- KPP ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit me shkrim të kandidatës, ku janë pasqyruar pikët e marra për secilën pyetje, si dhe shuma në total e pikëve (një pasqyrë).
- KPP ka kryer vlerësimin e jetëshkrimit të konkurrentes sipas procesverbalit të mbajtur, datë 29.08.2018.
- Në dosjen e dokumentacionit gjendet “*Deklarata për regjistrimin me zë të intervistës së strukturuar me gojë*”, sipas së cilës kandidatja nuk ka pranuar të regjistrohet.
- KPP ka hartuar listën e pyetjeve për intervistën me gojë, dhe është mbajtur procesverbali i vlerësimit të konkurrentëve për këtë fazë konkurrimi, datë 29.08.2018.
- Në përfundim të zhvillimit të të gjithë fazave të konkurrimit, është mbajtur procesverbali i vlerësimit përfundimtar të konkurrentit, si dhe procesverbali i renditjes me pikë të kandidatës në përfundim të vlerësimit, ku ka rezultuar fituese kandidatja ***** me 89 pikë.
- Memo e hartuar nga KPP, datë 29.08.2018, drejtuar Titullarit të institucionit për përfundimin e konkurrimit për pozicionin e punës “*Specialist në Drejtorinë e Çështjeve Procedurale Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë*”, dhe shpalljen fitues të kandidatës *****.
- Me aktin nr. 1184 prot., datë 30.08.2018, është kryer publikimi i fituesit në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, për pozicionin “*Specialist*”, në Drejtorinë e Çështjeve Procedurale Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë.
- Akti i emërimit për punonjësen është bërë me Urdhrin nr. 157, datë 31.08.2018, “*Për emërimin në detyrë të znj. ******”, të Komisionerit.

➤ **Procedura konkurrimi të realizuara në vitin 2019**

7. Procedura e rekrutimit për pozicionin “*Specialist i Jetësimit të Projekteve*”, në Drejtorinë e Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit

- Në zbatim të planit të rekrutimit akti nr. 95, datë 21.01.2019, “*Mbi miratimin e planit vjetor të pranimin në shërbimin civil për vitin 2019*”, institucioni me aktin nr. 1093 prot., datë 10.07.2019, “*Njoftim për shpalljen e vendeve vakante pjesë të shërbimit civil në institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, ka publikuar 4 pozicionet e lira, paraqitur si më poshtë:

- ✓ Drejtor, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse, niveli i pagës II-b.
 - ✓ Inspektor, në Drejtorinë e Hetimit Administrativ, niveli i pagës III-a.
 - ✓ Specialist i Jetësimin të Projekteve, në Drejtorinë e Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit, niveli i pagës III-b.
 - ✓ Specialist i Pritjes së Ankesave, në Zyrën Rajonale Fier, niveli i pagës IV-a
- Bashkëlidhur njoftimit gjendet “*Shpallje për lëvizje paralele/pranim në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive*”, publikuar në Shërbimin Kombëtar të Punësimin, për pozicionin “*Specialist i Jetësimin të Projekteve, në Drejtorinë e Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit*”, niveli i pagës III b.
 - Në këtë publikim është planifikuar lëvizje paralele, dhe pranimi në shërbimin civil, duke përcaktuar afatin e dorëzimit të dokumentacionit, për procedurën e lëvizjes paralele, data 21.07.2019 dhe për procedurën e pranimit në shërbimin civil, datë 26.07.2019.
 - Në përmbajtje të këtij publikim, është përfshirë përshkrimi i përgjithshëm i pozicionit të punës; kushtet për lëvizjen paralele/pranim në shërbimin civil, si dhe kriteret e posaçme që duhet të plotësojë kandidati për këtë pozicion pune. Gjithashtu, fusha e njohurive mbi të cilat do të zhvillohet testimi.
 - Nga dokumentacioni i shqyrtuar, rezulton se janë respektuar afatet e dorëzimit të dokumentacionit, si dhe afati i parashikuar për verifikimin paraprak të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët, për lëvizjen paralele datë 23.07.2019, dhe pranim në shërbimin civil datë 05.08.2019.
 - Me aktin e verifikimit për procedurën e lëvizjes paralele nr. 1148 prot., datë 23.07.2019, “*Lista e kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin për procedurën lëvizje paralele për konkursin “Specialist i Jetësimin të Projekteve, në Drejtorinë e Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit*”, njësia përgjegjëse ka publikuar në faqen zyrtare të Shërbimit Kombëtar të Punësimin, njoftimin se, kjo procedurë është mbyllur pa kandidatë.
 - Me aktin nr. 1230 prot., datë 06.08.2019, “*Lista e kandidatëve që do të vazhdojnë konkurrimin në procedurën “Pranim në shërbimin civil”, për konkursin “Specialist i Jetësimin të Projekteve, në Drejtorinë e Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit*”, është publikuar njoftimi në faqen zyrtare të SHKP, ku rezulton se, janë kualifikuar për të vazhduar konkurrimin në fazat e mëtejshme tre kandidatët që kishin aplikuar për këtë pozicion pune, pas verifikimit paraprak të njësisë përgjegjëse, ato janë:

- Sipas publikimit të bërë, testimi me shkrim është zhvilluar në datë 20.08.2019, ora 12.00, ndërsa testimi me shkrim është zhvilluar në datë 21.08.2019, ora 13.00, në ambientet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Me Urdhrin nr. 133, datë 30.07.2019, (nr. 1197 prot., datë 30.07.2019), “*Për ngritjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimit në nivelin ekzekutiv (KPP)*”, është miratuar përbërja e Komitetit të Pranimit, duke respektuar kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil.
- Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga anëtarët e KPP është nënshkruar “*Deklarata për vlerësimin e paanshmërisë së anëtarëve të Komitetit të Përhershëm të Pranimit*”, në një akt të vetëm, datë 20.08.2019.
- Nga verifikimi i dokumentacionit në dosjen personale të secilit kandidat, rezulton se, të tre kandidatët e paraqitur plotësojnë kriteret e posaçme të vendosura për pozicionin e shpallur.
- Sipas procesverbalit të mbajtur në datë 20.08.2019, “*Konstatimi i situatave të veçanta për pozicionin*”, nuk ka konstatime të tilla.
- Nga KPP është mbajtur procesverbali i konstatimit të prezencës datë 20.08.2019, ku janë paraqitur të tre kandidatët.
- Nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit është përpiluar Teza e provimit me shkrim, e cila bashkëlidhur ka edhe çelësin e përgjigjeve. Gjithashtu, bashkëlidhur gjendet edhe teza e përgjigjeve të kandidatëve pjesëmarrës në këtë fazë konkurrimi, fusha e pyetjeve përputhet me kërkesat e pozicionit të punës.
- KPP ka hartuar raport për vlerësimin e kandidatëve, ku është pasqyruar vlerësimi për testimin me shkrim, si dhe vlerësimi për intervistën e strukturuar me gojë, dhe në fund të raportit jepet rezultati përfundimtar për të tre kandidatët. Ndërkohë sipas Udhëzimit të DAP, nr. 2, datë 27.03.2015, vlerësimi i secilit kandidat duhet të kryhet veçmas nga kandidatët e tjerë, nga secili anëtar i KPP-së. Në përfundim të vlerësimit të secilit prej kandidatëve, KPP-ja duhet të hartojë procesverbalin për vlerësimin përfundimtar të të gjithë kandidatëve pjesëmarrës në procedurë.
- **Mungon në dosjen e dokumentacionit “*Deklarata për regjistrimin me zë të intervistës së strukturuar me gojë*”, sipas së cilës, kandidatët përpara intervistës duhet të japin pëlqimin e tyre për regjistrim ose jo.**

- KPP ka hartuar listën e pyetjeve për intervistën me gojë, dhe është mbajtur procesverbali i vlerësimit të konkurrentëve për këtë fazë konkurrimi, datë 22.08.2019.
- Në përfundim të zhvillimit të të gjithë fazave të konkurrimit, është mbajtur procesverbali për renditjen më pikë të kandidatëve në përfundim të vlerësimit të tyre, datë 22.08.2019; *****
- Në përfundim të procesit të vlerësimit, në mbështetje të nenit 22, të ligjit 152/2013, i ndryshuar, si dhe pikës 5, të Kreut IV, të VKM-së nr. 243, datë 18.03.2015, njësia përgjegjëse ka njoftuar individualisht secilin kandidat të skualifikuar përmes e-mailit zyrtar, konkretisht:
 - Kandidatja *****është njoftuar përmes e-mailit të datës 23.08.2019.
 - Kandidati *****është njoftuar përmes e-mailit të datës 23.08.2019.
- Memo e hartuar nga KPP, datë 22.08.2019, e hartuar nga Kryetarja e KPP-së, drejtuar Titullarit të institucionit dhe Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, “*Informacion mbi përfundimin e vlerësimit të kandidatëve pjesëmarrës në konkursin për pozicionin Specialist i Jetësimit të Projekteve, në Drejtorinë e Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit*”, për përfundimin e konkurrimit dhe shpalljen fitues të kandidates *****.
- Me aktin nr. 1246 prot., datë 23.08.2019, është kryer publikimi i fituesit në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, për pozicionin “*Specialist i Jetësimit të Projekteve, në Drejtorinë e Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit*”, në Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
- Me Urdhrin nr. 149, datë 30.08.2019, “*Për emërimin në detyrë të znj. Esmeralda Sulaj*”, është emëruar në pozicionin “*Specialist i Jetësimit të Projekteve, në Drejtorinë e Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit*”, nëpunës civil në periudhë prove.

8. Procedura e rekrutimit për pozicionin, “*Specialist Monitorimit dhe Raportimit*”, në Drejtorinë e Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit

- Në vazhdim të zbatimit të planit të rekrutimit, institucioni me e-mailin e datës 01.02.2019, bashkëlidhur “*Shpallje për lëvizje paralele, pranim në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive*”, ka publikuar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, pozicionin “*Specialist i Monitorimit dhe Raportimit*”, në Drejtorinë e Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit, kategoria ekzekutive, niveli i pagës III-b. Në këtë publikim është planifikuar lëvizje paralele dhe pranimi në shërbimin civil, duke përcaktuar dorëzimin

e dokumentacionit për procedurën e lëvizjes paralele, datë 11.02.2019 dhe pranimit në shërbimin civil, datë 18.02.2019.

- Në përmbajtje të këtij publikim, është përfshirë përshkrimi i përgjithshëm i pozicionit të punës; kushtet për lëvizjen paralele/ ngritje në detyrë/ pranim nga jashtë shërbimit civil, si dhe kriteret e posaçme që duhet të plotësojë kandidati për këtë pozicion pune. Gjithashtu, fusha e njohurive mbi të cilat do të zhvillohet testimi.
- Nga dokumentacioni i shqyrtuar, rezulton se, janë respektuar afatet e dorëzimit të dokumentacionit, si dhe afati i parashikuar për verifikimin paraprak të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët, (13.02.2019) për lëvizjen paralele dhe (28.02.2019) për pranim në shërbimin civil.
- Me Urdhrin nr. 31, datë 28.02.2019, “*Për ngritjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimit në nivelin ekzekutiv*”, është ngritur Komiteti i Pranimit, në përbërje me pesë anëtarë, dy prej të cilëve janë ekspert të jashtëm, dhe tre përfaqësues të institucionit, të cilët mbajnë 2 pozicione të nivelit mesëm drejtues dhe 1 nivelit ekzekutiv, i ndryshuar me Urdhrin nr. 35, datë 07.03.2019.
- Nga përmbajtja e Urdhrit për ngritjen e KPP-së, vihet re se, baza ligjore mbi të cilin është ngritur ky Komitet është në mbështetje të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave.
- Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga anëtarët e KPP-së është nënshkruar “*Deklarata për vlerësimin e paanshmërisë së anëtarëve të Komitetit të Përhershëm të Pranimit*”, në një akt të vetëm, datë 08.03.2019.
- Referuar “*Listës së vlerësimit paraprak të kandidatëve të kualifikuar*”, për të vazhduar me fazën e dytë të konkurrimit për vendin e lirë të punës “*Specialist i Monitorimit dhe Raportimit*”, në Drejtorinë Monitorimit, Raportimit dhe Kontrollit, të përpiluar nga njësia përgjegjëse, rezulton se, procedura për lëvizje paralele nuk ka patur kandidatë.
- Në procedurën e pranimit në shërbimin civil, ka patur pesë kandidatura, ku një kandidat është skualifikuar për fazat e mëtejshme të konkurrimit, ******, për shkak të mungesës së eksperiencës në punë, 5 vjet eksperiencë në profesion, rezulton me 2 vite përvojë pune.* Katër (4) kandidatë janë kualifikuar për fazat e mëtejshme, ky njoftim me rezultatin e verifikimi paraprak është publikuar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, me aktin nr. 324 prot., datë 28.02.2019, ku është saktësuar data dhe vendi i zhvillimit të testimit me shkrim (08.03.2019, ora 10.00) dhe testimit me gojë (08.03.2019, ora 13.00).

Në këtë akt janë parashikuar edhe afatet e ankimit të vendimeve, për kandidatët e s'kualifikuar.

- Nga verifikimi i dosjes personale të kandidateve rezulton se, dokumentacioni i dorëzuar është i plotë.
- Nga KPP-ja është përpiluar Teza e provimit me shkrim dhe i bashkëlidhet çelësi i përgjigjeve. Gjithashtu, përpara zhvillimit të testimit me shkrim, është mbajtur procesverbal prezence i kandidatëve të kualifikuar për këtë fazë, datë 08.03.2019.
- KPP ka mbajtur procesverbalin e datës 08.03.2019, “Për konstatimin e situatave të veçanta”, ku kandidati ***** ka kryer testimin me shkrim nëpërmjet kompjuterit për shkak të aftësive të veçanta, më pas nga Komisioni, fleta e testit është printuar dhe sekretuar.
- KPP ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit me shkrim të kandidatëve, ku janë pasqyruar pikët e marra për secilën pyetje, si dhe shuma në total e pikëve (një pasqyrë), për secilin kandidatë.
- KPP ka kryer vlerësimin e jetëshkrimit të konkurrentëve sipas procesverbalit të mbajtur, datë 08.03.2019.
- **Në dosjen e dokumentacionit mungon tek secili kandidat “Deklarata për regjistrimin me zë të intervistës së strukturuar me gojë”.**
- KPP ka hartuar listën e pyetjeve për intervistën me gojë, dhe është mbajtur procesverbali i vlerësimit të konkurrentëve për këtë fazë konkurrimi, datë 08.03.2019.
- Në përfundim të zhvillimit të të gjithë fazave të konkurrimit, është mbajtur procesverbali i vlerësimit përfundimtar të konkurrentëve, si dhe procesverbali i renditjes me pikë të kandidatëve në përfundim të vlerësimit, janë renditur si më poshtë vijon:

- Memo e hartuar nga KPP, datë 08.03.2019, drejtuar Titullarit të institucionit për përfundimin e konkurrimit për pozicionin e punës, “Specialist i Monitorimit dhe Raportimit”, në Drejtorinë e Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit, dhe shpalljen fitues të kandidatit *****, dhe renditjen në listë fituese të kandidates *****.

- Me aktin nr. 375 prot., datë 11.03.2019, është kryer publikimi i fituesit në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, për pozicionin “*Specialist i Monitorimit dhe Raportimit*”, në Drejtorinë e Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit.
- Kandidatja *****pas shpalljes së listës së fituesve në portalin e SHKP-së, ka paraqitur ankesë për rezultatin e arritur në testimin me shkrim. KPP në datë 18.03.2019 ka mbajtur procesverbalin për verifikimin e kësaj ankese, ku në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit të procedurës së konkurrimit, ka vendosur të lërë në fuqi, vlerësimin e mëparshëm për kandidaten ***** , duke e rivlerësuar në testimin me shkrim me 19 pikë.
- Me aktin nr. 431 prot., datë 19.03.2019, është kryer njoftimi për shpalljen e listës përfundimtare të fituesit për pozicionin “*Specialist i Monitorimit dhe Raportimit*”, kandidatin *****.
- Akti i emërimit për punonjësin ***** , “*Specialist i Monitorimit dhe Raportimit*”, në Drejtorinë e Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit, është bërë me Urdhrin nr. 48, datë 21.03.2019, “*Për emërimin në detyrë të ******”, të Komisionerit.

9. Procedura e rekrutimit për pozicionin, “*Specialist i pritjes së ankesave, Zyra Rajonale Fier*”.

- Në zbatim të planit të rekrutimit, institucioni me aktin nr.1093 prot., datë 10.07.2019, “*Njoftim për shpalljen e vendeve vakante pjesë të shërbimit civil në institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, ka publikuar pozicionin “*Specialist i Pritjes së Ankesave*”, në Zyrën Rajonale Fier, niveli i pagës IVa. Bashkëlidhur njoftimit gjendet “*Shpallje për lëvizje paralele/pranim në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive*”, publikuar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, për pozicionin “*Specialist i pritjes së ankesave*”, Zyra Rajonale Fier, niveli i pagës IV-a.
- Në këtë publikim është planifikuar lëvizje paralele dhe pranimi në shërbimin civil, duke përcaktuar afatin e dorëzimit të dokumentacionit, për procedurën e lëvizjes paralele, data 21.07.2019 dhe për procedurën e pranimit në shërbimin civil, datë 26.07.2019. Në përmbajtje të këtij publikim, është përfshirë përshtkrimi i përgjithshëm i pozicionit të punës; kushtet për lëvizjen paralele/pranim në shërbimin civil, si dhe kriteret e posaçme që duhet të plotësojë kandidati për këtë pozicion pune. Gjithashtu, fusha e njohurive mbi të cilat do të zhvillohet testimi.
- Nga dokumentacioni i shqyrtuar, rezulton se janë respektuar afatet e dorëzimit të dokumentacionit, si dhe afati i parashikuar për verifikimin paraprak të dokumentacionit

të dorëzuar nga kandidatët, për lëvizjen paralele datë 23.07.2019, dhe pranim në shërbimin civil datë 05.08.2019.

- Me aktin e verifikimit për procedurën e lëvizjes paralele nr. 1147 prot., datë 23.07.2019, *“Lista e kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin për procedurën lëvizje paralele për konkursin “Specialist i pritjes së ankesave, Zyra Rajonale Fier””*, njësia përgjegjëse ka publikuar në faqen zyrtare të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, njoftimin se, kjo procedurë është mbyllur pa kandidatë.
- Me aktin nr. 1229 prot., datë 06.08.2019, *“Lista e kandidatëve që do të vazhdojnë konkurrimin në procedurën “Pranim në shërbimin civil”, për konkursin “Specialist i pritjes së ankesave, Zyra Rajonale Fier””*, është publikuar njoftimi në faqen zyrtare të SHKP, ku rezulton se, janë kualifikuar për të vazhduar konkurrimin në fazat e mëtejshme tre kandidatët që kishin aplikuar për këtë pozicion pune, pas verifikimit paraprak të njësive përgjegjëse, ato janë:

- Sipas publikimit të bërë, testimi me shkrim është zhvilluar në datë 20.08.2019, ora 12.00, ndërsa testimi me shkrim është zhvilluar në datë 21.08.2019, ora 14.30, në ambientet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Me Urdhrin nr. 133, datë 30.07.2019, (nr. 1197 prot., datë 30.07.2019), *“Për ngritjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimit në nivelin ekzekutiv (KPP)”*, është miratuar përbërja e Komitetit të Pranimit, duke respektuar kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil.
- Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga anëtarët e KPP-së është nënshkruar *“Deklarata për vlerësimin e paanshmërisë së anëtarëve të Komitetit të Përhershëm të Pranimit”*, në një akt të vetëm, datë 20.08.2019.
- Nga verifikimi i dokumentacionit në dosjen personale të secilit kandidat, rezulton se, të tre kandidatët e paraqitur plotësojnë kriteret e posaçme të vendosura për pozicionin e shpallur.
- Sipas procesverbalit të mbajtur në datë 20.08.2019, *“Konstatimi i situatave të veçanta”*, nuk ka konstatime të tilla.
- Nga KPP është mbajtur procesverbali i konstatimit të prezencës datë 20.08.2019, ku janë paraqitur dy kandidatë që janë, ***** dhe *****.

- Nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit është përpiluar Teza e provimit me shkrim, e cila bashkëlidhur ka edhe çelësin e përgjigjeve. Gjithashtu, bashkëlidhur gjendet edhe teza e përgjigjeve të kandidatëve pjesëmarrës në këtë fazë konkurrimi, fusha e pyetjeve përputhet me kërkesat e pozicionit të punës.
- KPP ka hartuar raport për vlerësimin e kandidatëve, ku është pasqyruar vlerësimi për testimin me shkrim, si dhe vlerësimi për intervistën e strukturuar me gojë, dhe në fund të raportit jepet rezultati përfundimtar për të dy kandidatët veçmas.
- Në dosjen e dokumentacionit gjendet “*Deklarata për regjistrimin me zë të intervistës së strukturuar me gojë*”, sipas së cilës, kandidatët përpara intervistës kanë refuzuar regjistrimin gjatë intervistimit me gojë.
- KPP ka hartuar listën e pyetjeve për intervistën e strukturuar me gojë.
- Në përfundim të zhvillimit të të gjithë fazave të konkurrimit, është mbajtur procesverbali për renditjen më pikë të kandidatëve në përfundim të vlerësimit të tyre, datë 22.08.2019;
 - ***** fituese
 - ***** 54 pikë
- Në përfundim të procesit të vlerësimit, në mbështetje të nenit 22, të Ligjit 152/2013, i ndryshuar, si dhe pikës 5, të Kreut IV, të VKM-së nr. 243, datë 18.03.2015, njësia përgjegjëse e ka njoftuar individualisht kandidatin e skualifikuar përmes e-mailit zyrtar.
- Memo datë 22.08.2019, e hartuar nga Kryetarja e KPP-së, drejtuar Titullarit të institucionit dhe për dajeni Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, “*Informacion mbi përfundimin e vlerësimit të kandidatëve pjesëmarrës në konkursin për pozicionin Specialist i pritjes së ankesave, Zyra Rajonale Fier*”, për përfundimin e konkurrimit dhe shpalljen fitues të kandidatës *****
- Me aktin nr. 1263 prot., datë 23.08.2019, është kryer publikimi i fituesit në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, për pozicionin “*Specialist i pritjes së ankesave, Zyra Rajonale Fier*”, në institucionin Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Me Urdhrin nr. 150 prot., datë 30.08.2019, “*Për emërimin në detyrë të znj******”, është emëruar në pozicionin “*Specialist i pritjes së ankesave, Zyra Rajonale Fier*”, nëpunës civil në periudhë prove.

10. Procedura e rekrutimit për pozicionin, “Specialist i Komunikimit me Mediat”, në Drejtorinë e Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit

- Në vijim të zbatit të planit të rekrutimit, njësia përgjegjëse me e-mailin e datës 01.02.2019, *“Njoftim për shpalljen e vendeve vakante pjesë të shërbimit civil në institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, ka shpallur pozicionin e lirë *“Specialist i Komunikimit me Mediat”*, në Drejtorinë e Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit.
- Bashkëlidhur njoftimit gjendet *“Shpallje për lëvizje paralele/pranim në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive”*, publikuar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, për pozicionin *“Specialist i Komunikimit me Mediat”*, në Drejtorinë e Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit, niveli i pagës III-b.
- Në këtë publikim është planifikuar lëvizje paralele dhe pranimi në shërbimin civil, duke përcaktuar afatin e dorëzimit të dokumentacionit, për procedurën e lëvizjes paralele, data 11.02.2019 dhe për procedurën e pranimit në shërbimin civil, datë 18.02.2019. Në përmbajtje të këtij publikim, është përfshirë përshkrimi i përgjithshëm i pozicionit të punës; kushtet për lëvizjen paralele/pranim në shërbimin civil, si dhe kriteret e posaçme që duhet të plotësojë kandidati për këtë pozicion pune. Gjithashtu, fusha e njohurive mbi të cilat do të zhvillohet testimi.
- Nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se, janë respektuar afatet e dorëzimit të dokumentacionit, si dhe afati i parashikuar për verifikimin paraprak të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët, për lëvizjen paralele datë 13.02.2019, dhe pranim në shërbimin civil datë 28.02.2019.
- Me aktin e verifikimit për procedurën e lëvizjes paralele nr. 236 prot., datë 13.02.2019, *“Lista e kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin për procedurën lëvizje paralele për konkursin “Specialist i Komunikimit me Mediat”, në Drejtorinë e Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit”*, njësia përgjegjëse ka publikuar në faqen zyrtare të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, njoftimin se, kjo procedurë është mbyllur pa kandidatë.
- Me aktin nr. 326 prot., datë 28.02.2019, *“Lista e kandidatëve që do të vazhdojnë konkurrimin në procedurën “Specialist i Komunikimit me Mediat”, në Drejtorinë e Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit*, është publikuar njoftimi në faqen zyrtare të SHKP, ku rezulton se, janë kualifikuar për të vazhduar konkurrimin në fazat e mëtejshme dy kandidatët që kishin aplikuar për këtë pozicion pune. Pas verifikimit paraprak të njësisë përgjegjëse, ato janë:

- Sipas publikimit të bërë, testimi me shkrim është zhvilluar në datë 06.03.2019, ora 10.00, ndërsa testimi me gojë është zhvilluar në datë 06.03.2019, ora 14.00, në ambientet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Me Urdhrin nr. 31, datë 28.02.2019, (nr. 320 prot., datë 28.02.2019), “Për ngritjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimit në nivelin ekzekutiv (KPP)”, është miratuar përbërja e Komitetit të Pranimit, duke respektuar kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil.
- Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga anëtarët e KPP është nënshkruar “Deklarata për vlerësimin e paanshmërisë së anëtarëve të Komitetit të Përhershëm të Pranimit”, në një akt të vetëm.
- Nga verifikimi i dokumentacionit në dosjen personale të secilit kandidat, rezulton se, të dy kandidatët e paraqitur plotësojnë kriteret e posaçme të vendosura për pozicionin e shpallur.
- Sipas procesverbalit të mbajtur në datë 06.03.2019, “Konstatimi i situatave të veçanta për pozicionin”, nuk ka konstatime të tilla.
- Nga KPP është mbajtur procesverbali i konstatimit të prezencës datë 06.03.2019, ku janë paraqitur të dy kandidaturat.
- Nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit është përpiluar Teza e provimit me shkrim, e cila bashkëlidhur ka edhe çelësin e përgjigjeve. Gjithashtu, bashkëlidhur gjendet edhe teza e përgjigjeve të kandidatëve pjesëmarrës në këtë fazë konkurrimi, fusha e pyetjeve përputhet me kërkesat e pozicionit të punës.
- KPP ka hartuar raport për vlerësimin e kandidatëve, ku është pasqyruar vlerësimi për testimin me shkrim, si dhe vlerësimi për intervistën e strukturuar me gojë, dhe në fund të raportit jepet rezultati përfundimtar për të dy kandidatët.
- Në dosjen e dokumentacionit gjendet “Deklarata për regjistrimin me zë të intervistës së strukturuar me gojë”, sipas së cilës, kandidatët nuk kanë preferuar të regjistrohen gjatë intervistës së strukturuar me gojë.
- KPP ka hartuar listën e pyetjeve për intervistën e strukturuar me gojë, dhe është mbajtur procesverbali i vlerësimit të konkurrentëve për këtë fazë konkurrimi.

- Në përfundim të zhvillimit të të gjithë fazave të konkurrimit, është mbajtur procesverbali për renditjen më pikë të kandidatëve në përfundim të vlerësimit të tyre, datë 06.03.2019;
 - ***** , 94 pikë
 - ***** , 5 pikë
- Memo e datës 07.03.2019, e hartuar nga Kryetarja e KPP-së, drejtuar Titullarit të institucionit dhe për dijeni Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, “*Informacion mbi përfundimin e vlerësimit të kandidatëve pjesëmarrës në konkursin për pozicionin “Specialist i Komunikimit me Mediat”, në Drejtorinë e Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit, për përfundimin e konkurrimit dhe shpalljen fitues të kandidatit *****.*”
- Me aktin nr. 365 prot., datë 07.03.2019, është kryer publikimi i fituesit në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, për pozicionin “*Specialist i Komunikimit me Mediat*”, në Drejtorinë e Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Me Urdhrin nr. 44, datë 13.03.2019, “*Për emërimin në detyrë të z. ******”, është emëruar në pozicionin “*Specialist i Komunikimit me Mediat*”, në Drejtorinë e Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit, nëpunës civil në periudhë prove.

11. Procedura e rekrutimit për pozicionin, “Specialist i pritjes së ankesave”, në Drejtorinë e Pritjes së Ankesave

- Në zbatim të planit të rekrutimit akti nr. 95, datë 21.01.2019, “*Mbi miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për vitin 2019*”, njësia përgjegjëse me e-mail e datës 01.02.2019, “*Njoftim për shpalljen e vendeve vakante pjesë të shërbimit civil në institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, ka shpallur pozicionin e lirë “*Specialist i pritjes së ankesave*”, në Drejtorinë e Pritjes së Ankesave.
- Bashkëlidhur njoftimit gjendet “*Shpallje për lëvizje paralele/pranim në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive*”, publikuar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, për pozicionin “*Specialist i pritjes së ankesave*”, në Drejtorinë e Pritjes së Ankesave, niveli i pagës IV-a.
- Në këtë publikim është planifikuar lëvizje paralele dhe pranimi në shërbimin civil, duke përcaktuar afatin e dorëzimit të dokumentacionit, për procedurën e lëvizjes paralele, data 11.02.2019 dhe për procedurën e pranimit në shërbimin civil, datë 18.02.2019. Në përmbajtje të këtij publikim, është përfshirë përshkrimi i përgjithshëm i pozicionit të punës; kushtet për lëvizjen paralele/pranim në shërbimin civil, si dhe kriteret e

posaçme që duhet të plotësojë kandidati për këtë pozicion pune. Gjithashtu, fusha e njohurive mbi të cilat do të zhvillohet testimi.

- Nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se, janë respektuar afatet e dorëzimit të dokumentacionit, si dhe afati i parashikuar për verifikimin paraprak të tij, të dorëzuar nga kandidatët, për lëvizjen paralele datë 13.02.2019, dhe praninë në shërbimin civil datë 28.02.2019.
- Me aktin e verifikimit për procedurën e lëvizjes paralele nr. 237 prot., datë 13.02.2019, *“Lista e kandidatëve që do të vazhdojnë konkurrimin për procedurën lëvizje paralele për konkursin “Specialist i pritjes së ankesave”, në Drejtorinë e Pritjes së Ankesave”*, njësia përgjegjëse, ka publikuar në faqen zyrtare të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, njoftimin se, kjo procedurë është mbyllur pa kandidatë.
- Me aktin nr. 322 prot., datë 28.02.2019, *“Lista e kandidatëve që do të vazhdojnë konkurrimin në procedurën “Specialist i pritjes së ankesave”, në Drejtorinë e Pritjes së Ankesave ”*, është publikuar njoftimi në faqen zyrtare të SHKP-së, ku rezulton se, janë kualifikuar për të vazhduar konkurrimin në fazat e mëtejshme pesë kandidatët që kishin aplikuar për këtë pozicion pune. Pas verifikimit paraprak të njësisë përgjegjëse, ato janë:

- Sipas publikimit të bërë, testimi me shkrim është zhvilluar në datë 12.03.2019, ora 10.00, ndërsa testimi me gojë është zhvilluar në datë 15.03.2019, ora 11.00, në ambjentet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Me Urdhrin nr. 31, datë 28.02.2019, (nr. 320 prot., datë 28.02.2019), *“Për ngritjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimit në nivelin ekzekutiv (KPP)”*, është miratuar përbërja e Komitetit të Pranimit, duke respektuar kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil.
- Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga anëtarët e KPP është nënshkruar *“Deklarata për vlerësimin e paanshmërisë së anëtarëve të Komitetit të Përhershëm të Pranimit”*, në një akt të vetëm, datë 12.03.2019.
- Nga verifikimi i dokumentacionit në dosjen personale të secilit kandidat, rezulton se, të pestë kandidatët e paraqitur plotësojnë kriteret e posaçme të vendosura për pozicionin e shpallur.
- Sipas procesverbalit të mbajtur në datë 12.03.2019, *“Konstatimi i situatave të veçanta për pozicionin”*, nuk ka konstatime të tilla.

- Nga KPP është mbajtur procesverbali i konstatimit të prezencës datë 12.03.2019, ku janë paraqitur tre kandidatët, që janë: *****.
- Nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit është përpiluar Teza e provimit me shkrim, e cila bashkëlidhur ka edhe çelësin e përgjigjeve. Gjithashtu, bashkëlidhur gjendet edhe teza e përgjigjeve të kandidatëve pjesëmarrës në këtë fazë konkurrimi, fusha e pyetjeve përputhet me kërkesat e pozicionit të punës.
- KPP ka hartuar raport për vlerësimin e kandidatëve, ku është pasqyruar vlerësimi për testimin me shkrim, si dhe vlerësimi për intervistën e strukturuar me gojë, dhe në fund të raportit jepet rezultati përfundimtar për të tre kandidatët.
- Në dosjen e dokumentacionit gjendet “*Deklarata për regjistrimin me zë të intervistës së strukturuar me gojë*”, sipas së cilës, kandidatët nuk kanë preferuar të regjistrohen gjatë intervistës së strukturuar me gojë.
- KPP ka hartuar listën e pyetjeve për intervistën e strukturuar me gojë, dhe është mbajtur procesverbali i vlerësimit të konkurrentëve për këtë fazë konkurrimi.
- Në përfundim të zhvillimit të të gjithë fazave të konkurrimit, është mbajtur procesverbali për renditjen më pikë të kandidatëve në përfundim të vlerësimit të tyre, datë 15.03.2019;
 - ***** , 87 pikë, fituese
 - ***** , 85 pikë, në listë pritje
- Memo e datës 15.03.2019, e hartuar nga Kryetarja e KPP-së, drejtuar Titullarit të institucionit dhe për dajeni Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, “*Informacion mbi përfundimin e vlerësimit të kandidatëve pjesëmarrës në konkursin për pozicionin "Specialist i pritjes së ankesave", në Drejtorinë e Pritjes së Ankesave,*”, për përfundimin e konkurrimit dhe shpalljen fitues të kandidates *****.
- Me aktin nr. 429 prot., datë 19.03.2019, është kryer publikimi i fituesit në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, për pozicionin “*Specialist i pritjes së ankesave*”, në Drejtorinë e Pritjes së Ankesave, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Me Urdhrin nr. 50, datë 26.03.2019, “*Për emërimin në detyrë të znj. ******”, Aljona Doko është emëruar në pozicionin “*Specialist i pritjes së ankesave*”, në Drejtorinë e Pritjes së Ankesave, nëpunës civil në periudhë prove.

12. Procedura e rekrutimit për pozicionin, “*Specialist i pritjes së ankesave, në Zyrën Rajonale Korçë*”.

- Në zbatim të planit të rekrutimit akti nr. 95, datë 21.01.2019, *“Mbi miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për vitin 2019”*, njësia përgjegjëse me e-mail e datës 01.02.2019, *“Njoftim për shpalljen e vendeve vakante pjesë të shërbimit civil në institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, ka shpallur pozicionin e lirë *“Specialist i pritjes së ankesave, në Zyrën Rajonale Korçë”*.
- Bashkëlidhur njoftimit gjendet *“Shpallje për lëvizje paralele/pranim në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive”*, publikuar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, për pozicionin *“Specialist i pritjes së ankesave, në Zyrën Rajonale Korçë”*, niveli i pagës IVa.
- Në këtë publikim është planifikuar lëvizje paralele dhe pranimi në shërbimin civil, duke përcaktuar afatin e dorëzimit të dokumentacionit, për procedurën e lëvizjes paralele, data 11.02.2019 dhe për procedurën e pranimit në shërbimin civil, datë 18.02.2019. Në përmbajtje të këtij publikim, është përfshirë përshkrimi i përgjithshëm i pozicionit të punës; kushtet për lëvizjen paralele/pranim në shërbimin civil, si dhe kriteret e posaçme që duhet të plotësojë kandidati për këtë pozicion pune. Gjithashtu, fusha e njohurive mbi të cilat do të zhvillohet testimi.
- Nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se, janë respektuar afatet e dorëzimit të dokumentacionit, si dhe afati i parashikuar për verifikimin paraprak të tij, të dorëzuar nga kandidatët, për lëvizjen paralele datë 13.02.2019, dhe pranim në shërbimin civil datë 28.02.2019.
- Me aktin e verifikimit për procedurën e lëvizjes paralele nr. 233 prot., datë 13.02.2019, *“Lista e kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin për procedurën lëvizje paralele për konkursin “Specialist i pritjes së ankesave, në Zyrën Rajonale Korçë”*, njësia përgjegjëse, ka publikuar në faqen zyrtare të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, njoftimin se, kjo procedurë është mbyllur pa kandidatë.
- Me aktin nr. 323 prot., datë 28.02.2019, *“Lista e kandidatëve që do të vazhdojnë konkurrimin në procedurën “Specialist i pritjes së ankesave, në Zyrën Rajonale Korçë”*”, është publikuar njoftimi në faqen zyrtare të SHKP-së, ku rezulton se, është kualifikuar për të vazhduar konkurrimin në fazat e mëtejshme një kandidat, *****.
- Sipas publikimit të bërë, testimi me shkrim është zhvilluar në datë 12.03.2019, ora 10.00, ndërsa testimi me gojë është zhvilluar në datë 15.03.2019, ora 11.00, në ambjentet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

- Me Urdhrin nr. 31, datë 28.02.2019, (nr. 320 prot., datë 28.02.2019), “Për ngritjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimit në nivelin ekzekutiv (KPP)”, është miratuar përbërja e Komitetit të Pranimit, duke respektuar kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil.
- Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga anëtarët e KPP është nënshkruar “Deklarata për vlerësimin e paanshmërisë së anëtarëve të Komitetit të Përhershëm të Pranimit”, në një akt të vetëm, datë 12.03.2019.
- Nga verifikimi i dokumentacionit në dosjen personale të kandidatit, rezulton se, të plotëson kriteret e posaçme të vendosura për pozicionin e shpallur.
- Sipas procesverbalit të mbajtur në datë 12.03.2019, “Konstatimi i situatave të veçanta për pozicionin”, nuk ka konstatime të tilla.
- Nga KPP është mbajtur procesverbali i konstatimit të prezencës datë 12.03.2019, ku është paraqitur kandidati.
- Nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit është përpiluar Teza e provimit me shkrim, e cila bashkëlidhur ka edhe çelësin e përgjigjeve. Gjithashtu, bashkëlidhur gjendet edhe teza e përgjigjeve të kandidatit pjesëmarrës në këtë fazë konkurrimi, fusha e pyetjeve përputhet me kërkesat e pozicionit të punës.
- KPP ka hartuar raport për vlerësimin e kandidatëve, ku është pasqyruar vlerësimi për testimin me shkrim, si dhe vlerësimi për intervistën e strukturuar me gojë, dhe në fund të raportit jepet rezultatit përfundimtar për kandidatin.
- Në dosjen e dokumentacionit gjendet “Deklarata për regjistrimin me zë të intervistës së strukturuar me gojë”, sipas së cilës, kandidati nuk ka preferuar të regjistrohet gjatë intervistës së strukturuar me gojë.
- Në përfundim të zhvillimit të të gjithë fazave të konkurrimit, është mbajtur procesverbali datë 15.03.2019 për renditjen më pikë të kandidatit ***** , vlerësuar me 72 pikë.
- Memo e datës 15.03.2019, e hartuar nga Kryetarja e KPP-së, drejtuar Titullarit të institucionit dhe për dijeni Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, “Informacion mbi përfundimin e vlerësimit të kandidatëve pjesëmarrës në konkursin për pozicionin "Specialist i pritjes së ankesave, në Zyrën Rajonale Korçë””, për përfundimin e konkurrimit dhe shpalljen fitues të kandidatës *****.

- Me aktin nr. 430 prot., datë 19.03.2019, është kryer publikimi i fituesit në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, për pozicionin *"Specialist i pritjes së ankesave, në Zyrën Rajonale Korçë"*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Me Urdhrin nr. 52, datë 26.03.2019, *"Për emërimin në detyrë të znj. *****"*, ***** është emëruar në pozicionin *"Specialist i pritjes së ankesave, në Zyrën Rajonale Korçë"*, nëpunës civil në periudhë prove.

13. Procedura e rekrutimit për pozicionin, *"Specialist i pritjes së ankesave, në Zyrën Rajonale Shkodër"*.

- Në zbatim të planit të rekrutimit akti nr. 95, datë 21.01.2019, *"Mbi miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për vitin 2019"*, njësia përgjegjëse me e-mail e datës 01.02.2019, *"Njoftim për shpalljen e vendeve vakante pjesë të shërbimit civil në institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi"*, ka shpallur pozicionin e lirë *"Specialist i pritjes së ankesave, në Zyrën Rajonale Shkodër"*.
- Bashkëlidhur njoftimit gjendet *"Shpallje për lëvizje paralele/pranim në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive"*, publikuar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, për pozicionin *"Specialist i pritjes së ankesave, në Zyrën Rajonale Shkodër"*, niveli i pagës IVa.
- Në këtë publikim është planifikuar lëvizje paralele dhe pranimi në shërbimin civil, duke përcaktuar afatin e dorëzimit të dokumentacionit, për procedurën e lëvizjes paralele, data 11.02.2019 dhe për procedurën e pranimit në shërbimin civil, datë 18.02.2019. Në përmbajtje të këtij publikim, është përfshirë përshkrimi i përgjithshëm i pozicionit të punës; kushtet për lëvizjen paralele/pranim në shërbimin civil, si dhe kriteret e posaçme që duhet të plotësojë kandidati për këtë pozicion pune. Gjithashtu, fusha e njohurive mbi të cilat do të zhvillohet testimi.
- Nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se, janë respektuar afatet e dorëzimit të dokumentacionit, si dhe afati i parashikuar për verifikimin paraprak të tij, të dorëzuar nga kandidatët, për lëvizjen paralele datë 13.02.2019, dhe pranim në shërbimin civil datë 28.02.2019.
- Me aktin e verifikimit për procedurën e lëvizjes paralele nr. 238 prot., datë 13.02.2019, *"Lista e kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin për procedurën lëvizje paralele për konkursin "Specialist i pritjes së ankesave, në Zyrën Rajonale Shkodër"*", njësia

përgjegjëse, ka publikuar në faqen zyrtare të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, njoftimin se, kjo procedurë është mbyllur pa kandidatë.

- Me aktin nr. 321 prot., datë 28.02.2019, “*Lista e kandidatëve që do të vazhdojnë konkurrimin në procedurën "Specialist i pritjes së ankesave, në Zyrën Rajonale Shkodër"*”, është publikuar njoftimi në faqen zyrtare të SHKP-së, ku rezulton se, janë kualifikuar për të vazhduar konkurrimin në fazat e mëtejshme dy kandidatë, ***** dhe *****.
- Sipas publikimit të bërë, testimi me shkrim është zhvilluar në datë 12.03.2019, ora 10.00, ndërsa testimi me gojë është zhvilluar në datë 15.03.2019, ora 11.00, në ambientet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Me Urdhrin nr. 31, datë 28.02.2019, (nr. 320 prot., datë 28.02.2019), “*Për ngritjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimit në nivelin ekzekutiv (KPP)*”, është miratuar përbërja e Komitetit të Pranimit, duke respektuar kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil.
- Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga anëtarët e KPP është nënshkruar “*Deklarata për vlerësimin e paanshmërisë së anëtarëve të Komitetit të Përhershëm të Pranimit*”, në një akt të vetëm, datë 12.03.2019.
- Nga verifikimi i dokumentacionit në dosjen personale të kandidatëve, rezulton se, plotësojnë kriteret e posaçme të vendosura për pozicionin e shpallur, të dy kandidatët zotërojnë Diplomë në fushën e Drejtësisë.
- Sipas procesverbalit të mbajtur në datë 12.03.2019, “*Konstatimi i situatave të veçanta për pozicionin*”, nuk ka konstatime të tilla.
- Nga KPP është mbajtur procesverbali i konstatimit të prezencës datë 12.03.2019, ku janë paraqitur të dy kandidatët.
- Nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit është përpiluar Teza e provimit me shkrim, e cila bashkëlidhur ka edhe çelësin e përgjigjeve. Gjithashtu, bashkëlidhur gjendet edhe teza e përgjigjeve të kandidatit pjesëmarrës në këtë fazë konkurrimi, fusha e pyetjeve përputhet me kërkesat e pozicionit të punës.
- Sipas procesverbalit të mbajtur në datë 15.03.2019 nga KPP, rezulton se kandidati ***** , nuk është paraqitur në intervistën e strukturuar me gojë.

- KPP ka hartuar raport për vlerësimin e kandidatëve, ku është pasqyruar vlerësimi për testimin me shkrim, si dhe vlerësimi për intervistën e strukturuar me gojë, dhe në fund të raportit jepet rezultatit përfundimtar për kandidatët.
- Në dosjen e dokumentacionit gjendet “*Deklarata për regjistrimin me zë të intervistës së strukturuar me gojë*”, sipas së cilës, kandidati *****, nuk ka preferuar të regjistrohet gjatë intervistës së strukturuar me gojë.
- Në përfundim të zhvillimit të të gjithë fazave të konkurrimit, datë 15.03.2019 është mbajtur procesverbali për renditjen më pikë të kandidatit ***** (91 pikë) dhe ***** (47 pikë).
- Memo e datës 15.03.2019, e hartuar nga Kryetarja e KPP-së, drejtuar Titullarit të institucionit dhe për dijeni Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, “*Informacion mbi përfundimin e vlerësimit të kandidatëve pjesëmarrës në konkursin për pozicionin "Specialist i pritjes së ankesave, në Zyrën Rajonale Shkodër"*”, për përfundimin e konkurrimit dhe shpalljen fitues të kandidatës *****.
- Me aktin nr. 428 prot., datë 19.03.2019, është kryer publikimi i fituesit në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, për pozicionin “*Specialist i pritjes së ankesave, në Zyrën Rajonale Shkodër*”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Me Urdhrin nr. 51, datë 26.03.2019, “*Për emërimin në detyrë të znj******”, ***** është emëruar në pozicionin “*Specialist i pritjes së ankesave, në Zyrën Rajonale Shkodër*”, nëpunës civil në periudhë prove.

➤ **Procedura konkurrimi të realizuara në vitin 2020**

14. Procedura e rekrutimit për pozicionin, “Specialist”, në Drejtorinë Juridike

- Në zbatim të planit të rekrutimit akti nr. 354/1 prot., datë 28.02.2020, “*Mbi miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për vitin 2020*”, institucioni me aktin nr.1169 prot., datë 17.08.2020, “*Njoftim për shpalljen e vendeve vakante pjesë të shërbimit civil në institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, bashkëlidhur “*Shpallje për lëvizje paralele/pranim në shërbimin civil, në kategorinë ekzekutive*”, ka publikuar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, pozicionin “*Specialist*”, në Drejtorinë Juridike, niveli ekzekutiv, kategoria e pagës III-b.

- Në këtë publikim është planifikuar lëvizje paralele, dhe pranimi në shërbimin civil, duke përcaktuar afatin e dorëzimit të dokumentacionit, për procedurën e lëvizjes paralele, data 26.08.2020 dhe për procedurën e pranimit në shërbimin civil, datë 31.08.2020. Në përmbajtje të këtij publikim, është përfshirë përshkrimi i përgjithshëm i pozicionit të punës; kushtet për lëvizjen paralele/ pranim në shërbimin civil, si dhe kriteret e posaçme që duhet të plotësojë kandidati për këtë pozicion pune. Gjithashtu, fusha e njohurive mbi të cilat do të zhvillohet testimi.
- Nga dokumentacioni i shqyrtuar, rezulton se janë respektuar afatet e dorëzimit të dokumentacionit (26.08.2020) dhe (31.08.2020), si dhe afati i parashikuar për verifikimin paraprak të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët, (28.08.2020) dhe 10.09.2020)
- Me aktin e verifikimit për procedurën e lëvizjes paralele nr. 1069/1 prot., datë 28.08.2020, *“Lista e kandidatëve që do të vazhdojnë konkurimin për procedurën lëvizje paralele për konkursin “Specialist në Drejtorinë Juridike”*”, njësia përgjegjëse ka publikuar në faqen zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, njoftimin se për këtë procedurë nuk është paraqitur asnjë kandidaturë.
- Më datë 10.09.2020, me aktin nr. 1231 prot., datë 10.09.2020, *“Lista e kandidatëve që do të vazhdojnë konkurrimin në procedurën “Pranim në shërbimin civil”, për konkursin “Specialist në Drejtorinë Juridike”*”, është publikuar njoftimi në faqen zyrtare të SHKPA, ku rezulton se, e vetmja kandidaturë e kualifikuar për të vazhduar konkurrimin në fazat e mëtejshme është kandidatja *****.
- Sipas publikimit të bërë, testimi me shkrim është zhvilluar në datë 25.09.2020, ora 10.00, ndërsa testimi me gojë është zhvilluar në të njëjtën datë, në orën 13.00, në ambjentet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Me Urdhrin nr. 105, datë 15.09.2020, (nr. 1242 prot., datë 15.09.2020), *“Për ngritjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimit në nivelin ekzekutiv (KPP)”*, është miratuar përberja e Komitetit të Pranimit, duke respektuar kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil.
- Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga anëtarët e KPP është nënshkruar *“Deklarata për vlerësimin e paanshmërisë së anëtarëve të Komitetit të Përhershëm të Pranimit”*, në një akt të vetëm.

- Nga verifikimi i dosjes personale të kandidatës *****, gjendet dokumentacioni i plotë, i cili vërteton se kjo kandidatë plotëson kriteret e posaçme të vendosura për pozicionin e shpallur.
- Sipas procesverbalit të mbajtur në datë 25.09.2020, “Konstatimi i Situatave të veçanta për pozicionin”, nuk ka konstatime të tilla.
- Nga KPP është mbajtur procesverbali i konstatimit të prezencës datë 25.09.2020, një kandidatë e paraqitur *****.
- Nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit është përpiluar Teza e provimit me shkrim, e cila bashkëlidhur ka edhe çelësin e përgjigjeve. Gjithashtu, bashkëlidhur gjendet edhe teza e përgjigjeve të kandidatës, fusha e pyetjeve përputhet me kërkesat e pozicionit të punës.
- KPP ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit me shkrim të konkurrentes, ku janë pasqyruar pikët e marra për secilën pyetje, si dhe shuma në total e pikëve 60 pikë. (një pasqyrë).
- KPP ka kryer vlerësimin e jetëshkrimit të konkurrentës sipas procesverbalit të mbajtur datë 25.09.2020, në total 10 pikë.
- Nga ana e konkurrentes ***** është nënshkruar “Deklarata për regjistrimin me zë të intervistës së strukturuar me gojë”, sipas së cilës, nuk ka dëshiruar të regjistrohet.
- KPP ka hartuar listën e pyetjeve për intervistën me gojë, dhe është mbajtur procesverbali i vlerësimit të konkurrentes për këtë fazë konkurrimi, gjithsej 25 pikë.
- Në përfundim të zhvillimit të të gjithë fazave të konkurrimit, është mbajtur Raporti për rekrutimin në shërbimin civil, ku janë pasqyruar edhe një herë vlerësimi i konkurrentes Marsela Gjuzi, në secilën etapë të konkurrimit, në vlerësimin përfundimtar ka dale fituese me 78 pikë.
- Në përfundim të procedurës është hartuar procesverbali i renditjes përfundimtare, datë 25.09.2020.
- Memo datë 28.09.2020, e hartuar nga Kryetarja e KPP, drejtuar Titullarit të institucionit, “Informacion mbi përfundimin e vlerësimit të kandidatëve pjesëmarrës në konkursin për pozicionin Specialist në Drejtorinë Juridike”, për përfundimin e konkurrimit për pozicionin e punës “Specialist”, në Drejtorinë e Juridike, dhe shpalljen fitues të kandidatës *****.

- Me aktin nr. 1295 prot., datë 28.09.2020, “Njoftim për shpallje lista e fituesve me procedurën pranim në shërbimin civil”, për konkursin “Specialist në Drejtorinë Juridike”, është bërë publikimi në Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.
- Me Urdhrin nr. 111, datë 30.09.2020, “Për emërimin në detyrë të znj. *****”, ***** është emëruar në pozicionin “Specialiste”, në Drejtorinë Juridike, në periudhë prove.

Konkluzion: Në disa raste janë konstatuar mangësi në dokumentacionin që provon pëlqimin e konkurrentëve për regjistrimin e intervistës së strukturuar me gojë, ky fakt, evidentohet kryesisht në rekrutimet e vitit 2018, ndërkohë, në vitet 2019 e në vijim rezulton të jetë rregulluar.

b) Lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë për pozicionet e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues.

Rregullat procedurale të konkurrimit për të plotësuar pozicionet e punës në nivelin e ulët dhe të mesëm drejtues, (*lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë*), janë të parashikuara në nenet 25 dhe 26, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe Vendimin nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”.

Sipas përcaktimeve të mësipërme ligjore, edhe për këtë procedurë plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari, nga nëpunësit civil të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, e nëse me anën e kësaj procedure pozicionet e lira nuk plotësohen, atëherë vijon procedura për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, me procedurën konkurruese ngritje në detyrë.

Nga analiza e të dhënave të grumbulluara gjatë procesit të mbikëqyrjes, rezulton se, për periudhën objekt mbikëqyrjeje, Janar 2015 - Qershor 2021, nga njësia përgjegjëse e institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, janë shpallur **6** procedura konkurrimi për plotësimin e 5 pozicioneve të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, nga të cilat 3 procedura kanë përfunduar me ngritje në detyrë dhe 2 procedura me pranim nga jashtë shërbimit civil.

Kategoria e mesme drejtuese	4 pozicione
------------------------------------	--------------------

	<i>Ngritje në detyrë</i>	<i>Pranim nga jashtë</i>
	2	2
Kategoria e ulët drejtuese	1 pozicion	
	<i>Ngritje në detyrë</i>	<i>Pranim nga jashtë</i>
	1	0
Totali	3	2

Duhet përmendur fakti që procedura e konkurrimit për plotësimin e pozicionit të nivelit të mesëm drejtues, “*Drejtor, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse*”, e shpallur në vitin 2015, nuk ka mundur të realizohet pasi nuk është paraqitur asnjë kandidaturë as për ngritje në detyrë dhe as për pranim nga jashtë shërbimit civil.

Ky pozicion mbeti i lirë edhe gjatë vitit 2016 dhe u rishpall si vend i lirë për tu plotësuar nëpërmjet procedurës së konkurrimit në vitin 2017.

Gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, për këto pozicione, nga njësia përgjegjëse e institucionit, në përgjithësi është bërë përpjekje për të përmbushur rregullat e përcaktuara në nenin 26, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, Vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët drejtuese dhe të mesme drejtuese*”, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike, “*Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur*”, duke vepruar si më poshtë:

- ✓ Njësia përgjegjëse, ka bërë shpalljen e procedurës për vendet vakante, fillimisht nëpërmjet lëvizjes paralele dhe më pas, nëpërmjet ngritjes në detyrë, në portalin “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*”, si dhe në *Faqen Zyrtare*, të KMD, duke përcaktuar pozicionet e lira të punës, për të cilin do të zhvillohet konkurrimi; përshkrimin përgjithësues të pozicionit të punës, si dhe kushtet dhe kriteret e e veçanta që duhet të plotësojë kandidati për ngritjen në detyrë;
- ✓ Njësia përgjegjëse ka krijuar *Komitetin e Pranimit për Ngritjen në Detyrë*, sipas viteve që është zhvilluar procedura, në përbërje të të cilit janë 3 punonjës të institucionit; dy ekspertë, të jashtëm sipas fushës së vlerësimit;
- ✓ Pas verifikimit paraprak nga njësia përgjegjëse, lista me kandidatët e kualifikuar është shpallur në portalin “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*”, si dhe në *Faqen Zyrtare* të KMD;

- ✓ Kandidatët e kualifikuar, i janë nënshtruar intervistës së strukturuar me gojë dhe testimin me shkrim. Në përfundim të vlerësimit, Komiteti ka komunikuar vendimin e përzgjedhjes titullarit të institucionit dhe njësisë përgjegjëse, e cila, e ka shpallur fituesin në portalin “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*” dhe më pas, ka nxjerrë aktin e emërimit, në pozicionin përkatës (*titullari i institucionit*).

➤ ***Procedura të realizuara me ngritje në detyrë***

Njësia përgjegjëse e institucionit, ka realizuar 3 procedura konkurrimi për ngritje në detyrë, për plotësimin e pozicioneve që rezultojnë të lira, në përfundim të të cilave, ka nxjerrë aktet e emërimit si më poshtë:

1. ***** me aktin nr. 167, datë 14.11.2017, emërohet në pozicionin “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse (*ngritje në detyrë nga brenda institucionit*).
2. ***** me aktin nr. 45, datë 13.03.2019, emërohet në pozicionin “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit.
3. ***** me aktin nr. 1294/1 prot., datë 30.08.2019, emërohet në pozicionin “*Inspektor*”, në Drejtorinë e Hetimit Administrativ (*ngritje në detyrë nga brenda institucionit*).

Nga këqyrja e dokumentacionit të hartuar gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit, për pozicionin e nivelit të mesëm drejtues, “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit, si dhe për pozicionin e nivelit të ulët drejtues, “*Inspektor*”, në Drejtorinë e Hetimit Administrativ, konstatohet se janë përmbushur rregullat e përcaktuara në nenin 26, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore. Në momentin e aplikimit, kandidatët fitues, kanë qenë nëpunës civilë të konfirmuar.

Konkretisht, për punonjësit:

- ***** nëpunës civil i konfirmuar në nivelin e ulët drejtues, në pozicionin, “*Përgjegjës Sektori, në MZHETTS*”;
- ***** nëpunës civil i konfirmuar në nivelin ekzekutiv, në pozicionin, “*Specialiste*”, Drejtoria e Procedurave Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, KMD.

Konstatohet fakti që në procedurën ngritje në detyrë, për pozicionin, “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse, në momentin e aplikimit konkurrentja ***** ishte nëpunëse civile e konfirmuar në nivelin ekzekutiv, pozicioni “*Specialiste*”, në Drejtorinë e Procedurave Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, KMD, kategoria e pagës III-b.

Në këtë rast, në shpalljen e publikuar për vendin e lirë të punës, në rubrikën kushtet që duhet të plotësojë kandidati për procedurën ngritje në detyrë, është përcaktuar se, kandidati duhet të jetë nëpunës civil i konfirmuar, sipas kategorisë së pagës, niveli i pagës, III-a; III-a/1 dhe III-b.

Në rastin në fjalë, vlerësojmë se nga ana e njësisë përgjegjëse, nuk është kuptuar drejt ligji, pasi referimin e ka bërë vetëm tek kategoria e pagës dhe jo sipas kategorizimit të niveleve të nëpunësisë civile, sipas nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar. Në nenin 26, pika 3/b, përcaktohet se, *për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, mund të aplikojnë nëpunësit civilë të një kategorie paraardhëse, të punësuar në të njëjtin apo në një institucion tjetër të shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e veçanta për vendin/vendet e lira, nëpërmjet ngritjes në detyrë.*

Në këto rrethana, Komisioneri sjell në vëmendjen e njësisë përgjegjëse se, në të ardhmen, në rastet e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë duhet të vlerësohet njëkohësisht kategoria e nëpunësisë civile sipas nenit 19 dhe kategoria e pagës, me qëllim që të plotësohet kërkesa ligjore sipas nenit 26, pika 3/b.

Aktualisht, kjo nëpunëse kryen detyrën e “Drejtorit në Drejtorinë e Pritjes së Ankesave”, pozicion në të cilin është emëruar me aktin nr. 201, datë 01.01.2019, pas ristrukturimit të institucionit.

Nga të dhënat e administruara në dosjet e konkurrimit dhe dokumentacioni i publikuar në portalin Shërbimi Kombëtar i Punësimit, këto procedura janë realizuar si më poshtë:

1. Procedura e rekrutimit për pozicionin, “Drejtor”, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse (viti 2017).

- Institucioni me aktin nr. 940, datë 28.09.2017 “Njoftim për shpalljen dy pozicioneve të lira pjesë e shërbimit civil në institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, bashkëlidhur “Shpallje për lëvizje paralele, ngritjen në detyrë, në kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese”, ka publikuar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, pozicionin “Drejtor Drejtorie”, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse, kategoria niveli i mesëm drejtues, niveli i pagës II-b. Në këtë publikim është planifikuar lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë, duke përcaktuar dorëzimin e dokumentacionit për procedurën e lëvizjes paralele, datë 09.10.2017 dhe për procedurën e ngritjes në detyrë, datë 14.10.2017.

- Në përmbajtje të këtij publikimi, është përfshirë përshkrimi i përgjithshëm i pozicionit të punës; kushtet për lëvizjen paralele/ ngritje në detyrë, si dhe kriteret e posaçme që duhet të plotësojë kandidati për këtë pozicion pune. Gjithashtu, fusha e njohurive mbi të cilat do të zhvillohet testimi.
- Nga dokumentacioni i shqyrtuar, rezulton se janë respektuar afatet e dorëzimit të dokumentacionit, si dhe afati i parashikuar për verifikimin paraprak të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët, për lëvizjen paralele 12.10.2017, dhe për procedurën e ngritjes në detyrë 24.10.2017.
- Me Urdhrin nr. 156, datë 02.11.2017, *“Për ngritjen e Komitetit të Pranimit për Ngritjen në Detyrë, KPND”*, është ngritur Komiteti i Pranimit, në përbërjen me pesë anëtarë, dy prej të cilëve janë ekspert të jashtëm, dhe tre përfaqësues të institucionit, të cilët mbajnë pozicionet, 1 Titullari i institucionit, 1 pozicion i nivelit mesëm drejtues dhe 1 nivelit ekzekutiv.
Nga përmbajtja e Urdhrit për ngritjen e Komitetit të Pranimit (nr. 156, datë 02.11.2017), vihet re se, baza ligjore mbi të cilin është ngritur ky Komitet është në mbështetje të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, *“Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme”*, të Këshillit të Ministrave.
- Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga anëtarët e KPND-së është nënshkruar *“Deklarata për vlerësimin e paanshmërisë së anëtarëve të Komitetit të Ngritjes në Detyrë”*, në një akt të vetëm, datë 06.11.2017.
- Referuar *“Listës së vlerësimit paraprak të kandidatëve të kualifikuar”*, për të vazhduar me fazën e dytë të konkurrimit për vendin e lirë të punës *“Drejtor Drejtorie”*, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse, të përpiluar nga njësia përgjegjëse, rezulton se, procedura për lëvizje paralele nuk ka patur kandidatë.
- Në procedurën e ngritjes në detyrë kanë aplikuar 2 kandidatë, ku një kandidat është skualifikuar për fazat e mëtejshme të konkurrimit, bëhet fjalë për kandidatin ***** *për shkak të mungesës së kriterëve të veçanta, arsimit dhe kriteret e përgjithshme, mungesës së statusit të nëpunësit civil, është skualifikuar.*
- Për këtë fazë konkurrimi është kualifikuar kandidatja ***** , njoftimi me rezultatin e verifikimi paraprak është publikuar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, me aktin nr. 1037 prot., datë 24.10.2017, ku është saktësuar data dhe vendi i zhvillimit të testimit me shkrim (06.11.2017, ora 10.00) dhe testimit me gojë (06.11.2017, ora 12.00). Në këtë akt janë parashikuar edhe afatet e ankimit të vendimeve, për kandidatët e s’kualifikuar.

- Nga verifikimi i dosjes personale të kandidatit të kualifikuar, dokumentacioni i dorëzuar rezulton i plotë, evidentohet fakti se, kandidati është nëpunës civil i konfirmuar në kategorinë ekzekutive, niveli i pagës III-b.
- Nga KPND është përpiluar Teza e provimit me shkrim dhe i bashkëlidhet çelësi i përgjigjeve. Gjithashtu, përpara zhvillimit të testimit me shkrim, është mbajtur procesverbal prezence i kandidatëve të kualifikuar për këtë fazë.
- KPND ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit me shkrim të konkurentes ******, ku janë pasqyruar pikët e marra për secilën pyetje, si dhe shuma në total e pikëve 30 (një pasqyrë).
- KPND ka kryer vlerësimin e jetëshkrimit të konkurentes sipas procesverbalit të mbajtur, 13 pikë.
- Në dosjen e dokumentacionit nuk gjendet *“Deklarata për regjistrimin me zë të intervistës se strukturuar me gojë”*.
- KPND ka hartuar listën e pyetjeve për intervistën me gojë, dhe është mbajtur procesverbali i vlerësimit të konkurentes për këtë fazë konkurrimi, 36 pikë.
- Në përfundim të zhvillimit të të gjithë fazave të konkurrimit, është mbajtur procesverbali i vlerësimit përfundimtar të konkurrentes, si dhe procesverbali i renditjes me pikë të kandidatëve në përfundim të vlerësimit, në total 79 pikë.
- Memo e hartuar nga KPND, datë 07.11.2017, drejtuar njësisë përgjegjëse, për përfundimin e konkurrimit për pozicionin e punës *“Drejtor Drejtorie”*, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse, dhe shpalljen fitues të kandidates *****.
- Me aktin nr. 1119 prot., datë 14.11.2017, është kryer publikimi i fituesit në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, për pozicionin.
- Me aktin e emërimit nr. 167, datë 14.11.2017, *“Emërim në detyrë për *****”*, ******, emërohet në pozicionin *“Drejtor”*, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.

2. Procedura e rekrutimit për pozicionin “Drejtor”, në Drejtorinë e Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit (viti 2019)

- Në zbatim të planit të rekrutimit, akti nr. 95, datë 21.01.2019, “*Mbi miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për vitin 2019*”, institucioni me e-mailin e datës 01.02.2019, ka bashkëlidhur “*Shpallje për lëvizje paralele, ngritjen në detyrë dhe pranim nga jashtë shërbimit civil, në kategorinë e mesme drejtuese*”, ka publikuar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, pozicionin “*Drejtor Drejtorie*”, në Drejtorinë e Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit, kategoria niveli i mesëm drejtues, kategoria e pagës II b. Në këtë publikim është planifikuar lëvizje paralele, ngritje në detyrë dhe pranimi nga jashtë shërbimit civil, duke përcaktuar dorëzimin e dokumentacionit për procedurën e lëvizjes paralele, datë 11.02.2019 dhe për procedurën e ngritjes në detyrë dhe pranim nga jashtë, datë 18.02.2019.

Në përmbajtje të këtij publikim, është përfshirë përshkrimi i përgjithshëm i pozicionit të punës; kushtet për lëvizjen paralele/ ngritje në detyrë/ pranim nga jashtë shërbimit civil, si dhe kriteret e posaçme që duhet të plotësojë kandidati për këtë pozicion pune. Gjithashtu, fusha e njohurive mbi të cilat do të zhvillohet testimi.

- Nga dokumentacioni i shqyrtuar, rezulton se janë respektuar afatet e dorëzimit të dokumentacionit, si dhe afati i parashikuar për verifikimin paraprak të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët (13.02.2019) për lëvizjen paralele dhe (28.02.2019) për ngritjen në detyrë.
- Me Urdhrit nr. 30, datë 28.02.2019, “*Për ngritjen e Komitetit të Pranimit për Ngritjen në Detyrë, KPND*”, është ngritur Komiteti i Pranimit, në përbërjen me pesë anëtarë, dy prej të cilëve janë ekspert të jashtëm, dhe tre përfaqësues të institucionit, të cilët mbajnë 2 pozicione të nivelit mesëm drejtues dhe 1 nivelit ekzekutiv.

Nga përmbajtja e Urdhrit për ngritjen e Komitetit të Pranimit (nr. 30, datë 28.02.2019), vihet re se, baza ligjore mbi të cilin është ngritur ky Komitet është në mbështetje të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme*”, të Këshillit të Ministrave.

- Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga anëtarët e KPND është nënshkruar “*Deklarata për vlerësimin e paanshmërisë së anëtarëve të Komitetit të Ngritjes në Detyrë*”, në një akt të vetëm, datë 06.03.2019.
- Referuar “*Listës së vlerësimit paraprak të kandidatëve të kualifikuar*”, për të vazhduar me fazën e dytë të konkurrimit për vendin e lirë të punës “*Drejtor Drejtorie*”, në Drejtorinë Monitorimit, Raportimit dhe Kontrollit, të përpiluar nga njësi përgjegjëse, rezulton se, procedura për lëvizje paralele nuk ka patur kandidatë. Në procedurën e ngritjes në detyrë, ka patur dy kandidatura, ku një kandidat është skualifikuar për fazat e mëtejshme të konkurrimit, *****, për shkak të mungesës së eksperiencës në

punë, 2 vjet në nivel drejtues, për këtë fazë konkurrimi është kualifikuar kandidatja *****. Ky njoftim me rezultatin e verifikimi paraprak është publikuar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, me aktin nr. 325 prot., datë 28.02.2019, ku është saktësuar data dhe vendi i zhvillimit të testimit me shkrim (06.03.2019, ora 10.00) dhe testimit me gojë (06.03.2019, ora 14.00). Në këtë akt janë parashikuar edhe afatet e ankimit të vendimeve, për kandidatët e s'kualifikuar.

- Nga verifikimi i dosjes personale të kandidatës ***** , dokumentacioni i dorëzuar rezulton i plotë, dhe vërteton se kjo kandidate plotëson kriteret e posaçme të vendosura për pozicionin e shpallur.
- Nga KPND është përpiluar Teza e provimit me shkrim dhe i bashkëlidhet çelësi i përgjigjeve. Gjithashtu, përpara zhvillimit të testimit me shkrim, është mbajtur procesverbal prezence i kandidatëve të kualifikuar për këtë fazë.
- KPND ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit me shkrim të konkurrentes, ku janë pasqyruar pikët e marra për secilën pyetje, si dhe shuma në total e pikëve 83 (tetë dhjetë e tre. (një pasqyrë).
- KPND ka kryer vlerësimin e jetëshkrimit të konkurrentes sipas procesverbalit të mbajtur, datë 06.03.2019, 7 pikë.
- Në dosjen e dokumentacionit gjendet “*Deklarata për regjistrimin me zë të intervistës së strukturuar me gojë*”, sipas së cilës, kandidatja nuk ka pranuar të regjistrohet në intervistën me gojë.
- KPND ka hartuar listën e pyetjeve për intervistën me gojë, dhe është mbajtur procesverbali i vlerësimit të konkurrentes për këtë fazë konkurrimi, datë 06.03.2019, 40 pikë.
- Në përfundim të zhvillimit të të gjithë fazave të konkurrimit, është mbajtur procesverbali i vlerësimit përfundimtar të konkurrentes, si dhe procesverbali i renditjes me pikë të kandidatëve në përfundim të vlerësimit, në total 83 pikë.
- Memo e hartuar nga KPND, datë 07.03.2019, drejtuar Titullarit të institucionit për përfundimin e konkurrimit për pozicionin e punës “*Drejtor Drejtorie*”, në Drejtorinë Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit, dhe shpalljen fitues të kandidatës *****.

- Me aktin nr. 364 prot., datë 07.03.2019, është kryer publikimi i fituesit në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, për pozicionin “*Drejtor Drejtorie*”, në Drejtorinë Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit.
- Akti i emërimit për punonjësen *****”, “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Monitorimit, Raportimit dhe Komunikimit, Urdhër nr. 45, datë 13.03.2019, “*Për emërimin në detyrë të znj. ******”, të Komisionerit.

3. Procedura e rekrutimit për pozicionin, “*Inspektor*”, në Drejtorinë e Hetimit Administrativ (viti 2019)

- Në zbatim të planit të rekrutimit, akti nr. 95, datë 21.01.2019, “*Mbi miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për vitin 2019*”, institucioni me aktin nr.1093, datë 10.07.2019 “*Njoftim për shpalljen e vendeve vakante pjesë të shërbimit civil në institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, bashkëlidhur “*Shpallje për lëvizje paralele, ngritjen në detyrë, në kategorinë e mesme drejtuese dhe të ulët drejtuese*”, ka publikuar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, pozicionin “*Inspektor*”, në Drejtorinë e Hetimit Administrativ, kategoria niveli i ulët drejtues, niveli i pagës IIIa. Në këtë publikim është planifikuar lëvizje paralele, ngritje në detyrë në të njëjtën kohë, duke përcaktuar dorëzimin e dokumentacionit për procedurën e lëvizjes paralele, datë 21.07.2019 dhe për procedurën e ngritjes në detyrë, datë 26.07.2019.
- Në përmbajtje të këtij publikimi, është përfshirë përshtkrimi i përgjithshëm i pozicionit të punës; kushtet për lëvizjen paralele/ ngritje në detyrë, si dhe kriteret e posaçme që duhet të plotësojë kandidati për këtë pozicion pune. Gjithashtu, fusha e njohurive mbi të cilat do të zhvillohet testimi.
- Nga dokumentacioni i shqyrtuar, rezulton se janë respektuar afatet e dorëzimit të dokumentacionit, si dhe afati i parashikuar për verifikimin paraprak të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët, për lëvizjen paralele, data 23.07.2019 dhe për ngritjen në detyrë, data 05.08.2019.
- Me Urdhër nr. 132, datë 30.07.2019, “*Për ngritjen e Komitetit të Pranimit për Ngritjen në Detyrë, KPND*”, është ngritur Komiteti i Pranimit, në përbërjen me pesë anëtarë, dy prej të cilëve janë ekspert të jashtëm, dhe tre përfaqësues të institucionit, të cilët mbajnë 2 pozicione të nivelit mesëm drejtues dhe 1 nivelit ekzekutiv.
- Nga përmbajtja e Urdhrit për ngritjen e Komitetit të Pranimit (nr. 132, datë 30.07.2019), vihet re se, baza ligjore mbi të cilin është ngritur ky Komitet është në mbështetje të

Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme”, të Këshillit të Ministrave.

- Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga anëtarët e KPND-së është nënshkruar “Deklarata për vlerësimin e paanshmërisë së anëtarëve të Komitetit të Ngritjes në Detyrë”, në një akt të vetëm, datë 20.08.2019.
- Referuar “Listës së vlerësimit paraparak të kandidatëve të kualifikuar”, për të vazhduar me fazën e dytë të konkurrimit për vendin e lirë të punës “Inspektor”, në Drejtorinë e Hetimit Administrativ, të përpiluar nga njësia përgjegjëse, rezulton se, procedura për lëvizje paralele nuk ka patur kandidatë. Në procedurën e ngritjes në detyrë ka patur një kandidat të kualifikuar për fazat e mëtejshme të konkurrimit, *****.
- Për këtë fazë konkurrimi, njoftimi me rezultatin e verifikimi paraparak është publikuar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, me aktin nr. 1228 prot., datë 06.08.2019, ku është saktësuar data dhe vendi i zhvillimit të testimit me shkrim (20.08.2019, ora 10.00) dhe testimit me gojë (21.08.2019, ora 11.00).
- Nga verifikimi i dosjes personale të kandidatës, dokumentacioni i dorëzuar rezulton i plotë.
- Nga KPND është përpiluar Teza e provimit me shkrim dhe i bashkëlidhet çelësi i përgjigjeve. Gjithashtu, përpara zhvillimit të testimit me shkrim, është mbajtur procesverbal prezence i kandidatëve të kualifikuar për këtë fazë, ku rezulton se kandidatja *****; është e pranishme.
- KPND ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit me shkrim të konkurrentes, ku janë pasqyruar pikët e marra për secilën pyetje, si dhe shuma në total e pikëve 39 (një pasqyrë).
- KPND ka kryer vlerësimin e jetëshkrimit të konkurrentes sipas procesverbalit të mbajtur, datë 22.08.2019, 18 pikë.
- Në dosjen e dokumentacionit gjendet “Deklarata për regjistrimin me zë të intervistës së strukturuar me gojë”, sipas së cilës, kandidatja nuk ka pranuar të regjistrohet në intervistën me gojë.
- KPND ka hartuar listën e pyetjeve për intervistën me gojë, dhe është mbajtur procesverbali i vlerësimit të konkurrentes për këtë fazë konkurrimi, 40 pikë.

- Në përfundim të zhvillimit të të gjithë fazave të konkurrimit, është mbajtur procesverbali i vlerësimit përfundimtar të konkurrentes, si dhe procesverbali i renditjes me pikë në përfundim të vlerësimit, në total 97 pikë.
- Memo e hartuar nga KPND, datë 22.08.2019, drejtuar Titullarit të institucionit për përfundimin e konkurrimit për pozicionin e punës “*Inspektor*”, në Drejtorinë e Hetimit Administrativ, dhe shpalljen fitues të kandidatës *****.
- Me aktin nr. 1265 prot., datë 23.08.2019, është kryer publikimi i fituesit në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, për pozicionin.
- Me aktin e emërimit nr. 1294/1 prot., datë 30.08.2019, “*Emërim*”, ***** , emërohet në pozicionin “*Inspektor*”, në Drejtorinë e Hetimit Administrativ.

➤ ***Procedura ngritje në detyrë me kandidatë nga jashtë shërbimit civil.***

Në nenin 26, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, përcaktohet se, organi kompetent, për institucionet e pavarura, mund të vendosë që procedura e plotësimit të vendeve të lira në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese të jetë e hapur edhe për kandidatë nga jashtë shërbimit civil, me kusht që ata të plotësojnë kriteret dhe kërkesat për vendin/vendet e lira.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga institucioni, për periudhën objekt mbikëqyrjeje, rezulton se këtë dispozitë ligjore, ashtu siç e kemi përmendur më sipër në material, (*hartimi i planit vjetor të pranimit në shërbimin civil*) institucioni i KMD, e ka formalizuar shkresërisht vetëm për vitin 2019, pavarësisht aplikimit edhe në vitet e mëparshme.

Për periudhën Janar 2015-Qershor 2021, janë publikuar 3 procedura konkurrimi për ngritje në detyrë, me kandidat nga jashtë shërbimit civil, për pozicionin “*Drejtore Drejtorie*”, nga të cilat janë realizuar 2 procedura.

Në përfundim të procedurave të realizuara, njësia përgjegjëse ka nxjerrë aktet e emërimit për kandidatët fitues, si më poshtë:

1. *****₁ me aktin nr. 72, datë 18.05.2015, emërohet në pozicionin, “*Drejtore*”, në Drejtorinë e Procedurave Ligjore dhe Marrëdhënive me Jashtë.
2. *****₂ me aktin e emërimit nr. 1585 prot., datë 17.11.2020, emërohet në pozicionin, “*Drejtore*”, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.

Konkluzion: Komisioneri vlerëson se procedurat e konkurrimit të zhvilluara për plotësimin e pozicioneve të nivelit të mesëm drejtues, nëpërmjet procedurës me pranim nga jashtë shërbimit civil, në përgjithësi janë realizuar sipas përcaktimeve të nenit 26, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Vendimin nr.242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët drejtuese dhe të mesme drejtuese”, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike, “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”.

Megjithatë, sjellim në vëmendje të njësisë përgjegjëse të institucionit, se në momentin që harton dhe miraton planin e nevojave për rekrutim në pozicionet e shërbimit civil, për vitin respektiv, duhet të përcaktojë edhe numrin e pozicioneve të kategorisë së ulët dhe të mesme drejtuese të cilat do të plotësohen me kandidatë nga jashtë shërbimit civil, duke respektuar që të mos kapërcejë kufirin e 20%, të numrit total të vendeve të lira për çdo vit kalendarik.

Më poshtë po rendisim procedurat e konkurrimit të realizuara në këtë kategori, duke paraqitur të dhënat e administruara në dosjet e konkurrimit dhe dokumentacionin e publikuar në faqen zyrtare të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, të cilat janë realizuar si më poshtë:

1. Procedura e rekrutimit për pozicionin, “Drejtor”, në Drejtorinë e Procedurave Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

- Në zbatim të planit të rekrutimit, institucioni, me aktin nr. 236/1 prot., datë 12.03.2015, “Kërkesë për shpalljen e vendeve të lira të punës në institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, bashkëlidhur “Njoftim për vend të lirë pune”, ka publikuar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, pozicionin “Drejtor Drejtorie”, në Drejtorinë e Procedurave Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, kategoria niveli i mesëm drejtues, kategoria e pagës II-b. Në këtë publikim është planifikuar lëvizje paralele, ngritje në detyrë dhe pranimi nga jashtë shërbimit civil, duke përcaktuar afatin e dorëzimit të dokumentacionit të njëjtë për të treja procedurat, datë (08.04.2015).
- Në përmbajtje të këtij publikimi, është përfshirë përshtkrimi i përgjithshëm i pozicionit të punës; kushtet për lëvizjen paralele/ ngritje në detyrë/ pranim nga jashtë shërbimit civil, si dhe kriteret e posaçme që duhet të plotësojë kandidati për këtë pozicion pune. Gjithashtu, fusha e njohurive mbi të cilat do të zhvillohet testimi.

- Nga dokumentacioni i shqyrtuar, rezulton se janë respektuar afatet e dorëzimit të dokumentacionit (08.04.2015), si dhe afati i parashikuar për verifikimin paraprak të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët (10.04.2015).
- Me Urdhrin nr. 58, datë 07.05.2015, *“Për ngritjen e Komitetit të Përherhshëm të Pranimit për kategorinë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”*, është ngritur Komiteti i Pranimit, në përbërjen me pesë anëtarë, dy prej të cilëve janë ekspert të jashtëm (të pacaktuar nominalisht), dhe tre përfaqësues të institucionit, të cilët mbajnë pozicione të nivelit ulët drejtues dhe nivelit ekzekutiv.
- Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga anëtarët e Komitetit të Pranimit është nënshkruar *“Deklarata për vlerësimin e paanshmërisë së anëtarëve të Komitetit të Pranimit”*, në një akt të vetëm.
- Referuar *“Listës së vlerësimit paraprak të kandidatëve të kualifikuar”*, për të vazhduar me fazën e dytë të konkurrimit për vendin e lirë të punës *“Drejtor Drejtorie”*, në Drejtorinë e Procedurave Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të përpiluar nga njësia përgjegjëse, rezulton se, procedura për lëvizje paralele/ ngritje në detyrë nuk ka patur kandidatë.
- Në procedurën e pranimit nga jashtë shërbimit civil, ka patur dy kandidatura, ku një kandidatë është kualifikuar për fazat e mëtejshme të konkurrimit, *****.
- Kadidatja e dytë ***** është skualifikuar pasi nuk plotësonte një nga kriteret e posaçme, 3 vjet në nivel drejtues ose barazvlefshëm me pozicionin e konkurrimit.
- Njoftimi me rezultatin e verifikimi paraprak është publikuar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, me aktin nr. 389 prot., datë 27.04.2015, ku është saktësuar data dhe vendi i zhvillimit të testimit me shkrim. Në këtë akt janë parashikuar edhe afatet e ankimit të vendimeve, për kandidatët e s’kualifikuar.
- Nga verifikimi i dosjes personale të kandidatës ***** , gjendet dokumentacioni i plotë, i cili vërteton se kjo kandidatë plotëson kriteret e posaçme të vendosura për pozicionin e shpallur.
- Komiteti i Përherhshëm i Pranimit ka përpiluar Tezën e provimit me shkrim, e cila nuk është e sekretuar dhe nuk i bashkëlidhet çelësi i përgjigjeve. Gjithashtu, përpara zhvillimit të testimit me shkrim, është mbajtur procesverbal prezence i kandidatëve të kualifikuar për këtë fazë.

- KPP ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit me shkrim të konkurrentes, ku janë pasqyruar pikët e marra për secilën pyetje, si dhe shumën në total të pikëve. (një pasqyrë).
- KPP ka kryer vlerësimin e jetëshkrimit të konkurrentës sipas procesverbalit të mbajtur.
- KPP ka hartuar listën e pyetjeve për intervistën me gojë, dhe është mbajtur procesverbali i vlerësimit të konkurrentes për këtë fazë konkurrimi.
- Në përfundim të zhvillimit të të gjithë fazave të konkurrimit, është mbajtur procesverbali i vlerësimit përfundimtar të konkurrentes, si dhe procesverbali i renditjes me pikë të kandidatëve në përfundim të vlerësimit, në total 91 pikë.
- Memo e hartuar nga KPP, datë 12.05.2015, drejtuar Titullarit të institucionit për përfundimin e konkurrimit për pozicionin e punës “*Drejtor Drejtorie*”, në Drejtorinë e Procedurave Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, dhe shpalljen fitues të kandidatës *****.
- Me aktin nr. 459 prot., datë 13.05.2015, është kryer publikimi i fituesit në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, për pozicionin “*Drejtor Drejtorie*”, në Drejtorinë e Procedurave Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë.
- Me aktin nr. 460 prot., datë 13.05.2015, njësi përgjegjëse ka njoftuar Titullarin për përfundimin e fazës së dytë të konkurrimit dhe shpalljen e fituesit, ***** , për pozicionin “*Drejtor Drejtorie*”, në Drejtorinë e Procedurave Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë”, në institucionin Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Emëruar me aktin nr. 72, datë 18.05.2015, “*Për emërim në detyrë*”, znj. ***** , në pozicionin “*Drejtor Drejtorie*”, në Drejtorinë e Procedurave Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, në institucionin Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

2. Procedura e rekrutimit për pozicionin “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.

- Në zbatim të planit të rekrutimit, institucioni me aktin nr. 1093, datë 10.07.2019 “*Njoftim për shpalljen e vendeve vakante pjesë të shërbimit civil në institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, bashkëlidhur “*Shpallje për lëvizje paralele, ngritjen në detyrë dhe praninë nga jashtë shërbimit civil, në kategorinë e mesme drejtuese*”, ka publikuar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, pozicionin “*Drejtor Drejtorie*”, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse, kategoria niveli i mesëm

drejtues, kategoria e pagës II-b. Në këtë publikim është planifikuar lëvizje paralele, ngritje në detyrë dhe pranimit nga jashtë shërbimit civil, duke përcaktuar dorëzimin e dokumentacionit për procedurën e lëvizjes paralele, datë 21.07.2019 dhe për procedurën e ngritjes në detyrë dhe pranimit nga jashtë, datë 26.07.2019.

- Në përmbajtje të këtij publikimi, është përfshirë përshkrimi i përgjithshëm i pozicionit të punës; kushtet për lëvizjen paralele/ ngritje në detyrë/ pranimit nga jashtë shërbimit civil, si dhe kriteret e posaçme që duhet të plotësojë kandidati për këtë pozicion pune. Gjithashtu, fusha e njohurive mbi të cilat do të zhvillohet testimi.
- Nga dokumentacioni i shqyrtuar, rezulton se janë respektuar afatet e dorëzimit të dokumentacionit, si dhe afati i parashikuar për verifikimin paraprak të dokumentacionit të dorëzuar nga kandidatët.
- Me Urdhrin nr. 132, datë 30.07.2019, “Për ngritjen e Komitetit të Pranimit për Ngritjen në Detyrë, KPND”, është ngritur Komiteti i Pranimit, në përbërjen me pesë anëtarë, dy prej të cilëve janë ekspert të jashtëm, dhe tre përfaqësues të institucionit, të cilët mbajnë 2 pozicione të nivelit mesëm drejtues dhe 1 nivelit ekzekutiv.
- Nga përmbajtja e Urdhrit për ngritjen e Komitetit të Pranimit (nr. 132, datë 30.07.2019), vihet re se, baza ligjore mbi të cilin është ngritur ky Komitet është në mbështetje të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme”, të Këshillit të Ministrave.
- Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga anëtarët e KPND-së është nënshkruar “Deklarata për vlerësimin e paanshmërisë së anëtarëve të Komitetit të Ngritjes në Detyrë”, në një akt të vetëm, datë 20.08.2019.
- Referuar “Listës së vlerësimit paraprak të kandidatëve të kualifikuar”, për të vazhduar me fazën e dytë të konkurrimit për vendin e lirë të punës “Drejtor Drejtorie”, në Drejtorinë Shërbimeve Mbështetëse, të përpiluar nga njësia përgjegjëse, rezulton se, procedura për lëvizje paralele nuk ka patur kandidatë. Në procedurën e ngritjes në detyrë nuk ka pasur kandidatë, në procedurën e pranimit nga jashtë shërbimit civil, ka patur dy kandidatura të kualifikuara dhe një kandidat është skualifikuar për fazat e mëtejshme të konkurrimit, *****, për shkak të mungesës së kriterëve të veçanta, zotëron diplomë të nivelit Master Profesional në Shkenca Ekonomike (60 kredite).
- Për këtë fazë konkurrimi janë kualifikuar kandidatët ***** dhe *****, njoftimi me rezultatin e verifikimi paraprak është publikuar në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, me aktin nr. 1227 prot., datë 06.08.2019, ku është saktësuar data dhe vendi i

zhvillimit të testimit me shkrim (20.08.2019, ora 10.00) dhe testimit me gojë (21.08.2019, ora 10.00). Në këtë akt janë parashikuar edhe afatet e ankimit të vendimeve, për kandidatët e s'kualifikuar.

- Nga verifikimi i dosjes personale të kandidatëve, dokumentacioni i dorëzuar rezulton i plotë.
- Nga KPND është përpiluar Teza e provimit me shkrim dhe i bashkëlidhet çelësi i përgjigjeve. Gjithashtu, përpara zhvillimit të testimit me shkrim, është mbajtur procesverbal prezence i kandidatëve të kualifikuar për këtë fazë, ku rezulton se kandidati ***** , nuk është paraqitur.
- KPND ka mbajtur procesverbalin e vlerësimit me shkrim të konkurrentes ***** , ku janë pasqyruar pikët e marra për secilën pyetje, si dhe shuma në total e pikëve 33 (një pasqyrë).
- KPND ka kryer vlerësimin e jetëshkrimit të konkurrentes sipas procesverbalit të mbajtur, datë 22.08.2019, 14 pikë.
- Në dosjen e dokumentacionit gjendet “*Deklarata për regjistrimin me zë të intervistës se strukturuar me gojë*”, sipas së cilës, kandidatja nuk ka pranuar të regjistrohet në intervistën me gojë.
- KPND ka hartuar listën e pyetjeve për intervistën me gojë, dhe është mbajtur procesverbali i vlerësimit të konkurrentes për këtë fazë konkurrimi, datë 06.03.2019, 35 pikë.
- Në përfundim të zhvillimit të të gjithë fazave të konkurrimit, është mbajtur procesverbali i vlerësimit përfundimtar të konkurrentes ***** , si dhe procesverbali i renditjes me pikë në përfundim të vlerësimit, në total 82 pikë.
- Memo e hartuar nga KPND, datë 22.08.2019, drejtuar Titullarit të institucionit për përfundimin e konkurrimit për pozicionin e punës “*Drejtor Drejtorie*”, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse, dhe shpalljen fitues të kandidates *****.
- Me aktin nr. 1266 prot., datë 23.08.2019, është kryer publikimi i fituesit në Shërbimin Kombëtar të Punësimit, për pozicionin.

- Me aktin e emërimit nr. 1585 prot., datë 17.11.2020, “*Akti i deklaramit të statusit të nëpunësit civil*”, ***** , është emëruar nëpunës civil në pozicionin, “*Drejtor*”, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse.

c) **Listat e pritjes dhe funksionimi i saj në KMD**

Sipas legjislacionit për nëpunësin civil, procedura e konkurrimit përfundon me emërimin e kandidatit në pozicionin e punës, për të cilin është shpallur fitues.

Ligji nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në nenin 22, pika 5, ka përcaktuar që: “*Kandidatët fitues, që marrin mbi 70 përqind të pikëve totale të vlerësimit, renditen nga komiteti i përhershëm i pranimit, sipas pikëve të marra në listën e kandidatëve të suksesshëm*”.

Në vazhdim ligji ka parashikuar që në rastet kur, për një konkurrim janë shpallur më shumë fitues, se sa pozicionet vakante për të cilat është zhvilluar procedura e hapur e konkurrimit, njësi përgjegjëse, në zbatim të nenit 23, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe pikës 18, të Kreut IV, të vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, i rendit kandidatët fitues, të cilët nuk janë emëruar për shkak të mungesës së vendeve vakante apo për shkak të refuzimit të ligjshëm, në një listë me vlefshmëri 2- vjeçare. Nëse gjatë kësaj periudhe njësi përgjegjëse zhvillon një procedurë konkurrimi për të njëjtin grup pozicionesh, kandidatët fitues, të paemëruar ende, rirenditen në listën fituese të konkurrimit përkatës sipas rezultatit përfundimtar.

Nga këqyrja e dokumentacionit të procedurave të konkurrimit për pranim në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive, të zhvilluara në institucionin e KMD, në periudhën objekt mbikëqyrje (Janar 2015 – Qershor 2021), rezulton që në 3 procedura, ka patur më shumë se 1 kandidat fitues që janë:

- ***** me 71 pikë (*listëpritje nga nëntor 2017 deri në nëntor 2019*)
- ***** fituese në 2 procedura, përkatësisht me 86 dhe 85 pikë (*listëpritje nga mars 2019 deri në mars 2021*)

Rezulton që gjatë periudhës së vlefshmërisë së listës së fituesve, megjithëse janë zhvilluar procedura konkurrimi për të njëjtin grup pozicionesh dhe ku kandidatët fitues i plotësonin kërkesat e veçanta për pozicionin e punës, njësi përgjegjëse e institucionit nuk i ka rirenditur në listën fituese sipas rezultatit në përfundim të procedurës së konkurrimit.

Ndërkohë rezulton që për të dyja kandidatet fituese, ka përfunduar vlefshmëria e listës së fituesve.

Konkluzion: Nga sa më sipër, Komisioneri vlerëson se veprimet e njësisë përgjegjëse të institucionit, në lidhje me administrimin e listës së fituesve gjatë periudhës 2- vjeçare të vlefshmërisë së saj, nuk janë kryer në përputhje me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil.

Sjellim në vëmendje të njësisë përgjegjëse që në rastet kur në përfundim të procedurës së konkurrimit, KPP ka renditur në listën e fituesve më shumë se 1 fitues me mbi 70 përqind të pikëve, brenda periudhës 2- vjeçare të vlefshmërisë së kësaj liste, në zbatim të nenit 23, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, fillimisht duhet të aplikohet lista e pritjes dhe në rast se zhvillohen procedura të tjera konkurrimi për të njëjtin grup pozicionesh dhe atje ku kandidati/kandidatët plotëson kërkesat e veçanta, duhet të rirenditen kandidatët sipas rezultatit përfundimtar.

III. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, u verifikua përmbushja e kërkesave ligjore të periudhës së provës, të përcaktuara nga neni 24, i ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, Kreu V, i Vendimit nr. 143, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese*”, i shfuqizuar, (për të gjitha ato procedura që kanë filluar gjatë kohës që ka qenë në fuqi kjo VKM), si dhe Kreun VI, i Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”.

Në mbështetje të këtyre dispozitave ligjore, nëpunësi në periudhë prove është i detyruar të ndjekë programin e detyrueshëm të trajnimit për periudhën e provës pranë ASPA-s dhe udhëzimet e nëpunësit më të vjetër civil, nën kujdesin e të cilit ai është vendosur.

Eprori direkt i nëpunësit në periudhë prove, duhet të caktojë nëpunësin më të vjetër nën kujdesin e të cilit do të vendoset nëpunësi civil në periudhë prove, të bëjë vlerësimin e rezultateve individuale në punë për periudhën e provës dhe të nxjerrë vendimin për përfundimin e periudhës së provës.

Në zbatim të planit të mbikëqyrjes, grupi i punës verifikoi tërësinë e veprimeve të kryera për konfirmimin e nëpunësve civilë, të cilët i janë nënshtruar periudhës së provës dhe që aktualisht vazhdojnë marrëdhëniet e punësimit me institucionin.

Gjatë procesit të verifikimit u konstatua se, në institucionin e KMD, për periudhën Janar 2015-Maj 2021, janë emëruar nëpunës civilë në periudhë prove 13 punonjës.

Në momentin e realizimit të mbikëqyrjes, rezulton se, për 13 punonjës, ka mbaruar periudha e provës, ku 12 prej tyre janë konfirmuar nëpunës civilë, ndërsa 1 punonjës është ende i pa konfirmuar pasi është në pritje për të kryer trajnimin e detyrueshëm pranë ASPA-s.

Për të gjitha këto raste, u verifikua përmbushja e kërkesave ligjore të periudhës së provës në bazë të të cilave, nëpunësi civil, është i detyruar që:

- ✓ të kryejë ciklin e detyrueshëm të trajnimit pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) dhe ,
- ✓ të ndjekë udhëzimet e nëpunësit më të vjetër, nën kujdesin e të cilit ai është i vendosur.

Nga këqyrja e akteve, rezulton se, në përfundim të periudhës së provës, bazuar në rezultatet e testimit në ASPA dhe në vlerësimin e rezultateve individuale në punë, për këta nëpunës, eprori direkt, ka vendosur konfirmimin si nëpunës civilë në pozicionet përkatëse. Konstatohet se, në të gjitha rastet, mungon mendimi me shkrim i nëpunësit civil më të vjetër në detyrë, udhëzimet e të cilit duhet të ndjekë nëpunësi civil në periudhë prove, detyrim që rrjedh nga pika 2/b dhe pika 4, e Kreut VI, të vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”.

Ky është një detyrim ligjor që eprori direkt dhe njësia përgjegjëse, duhet ta ketë në vëmendje për ta zbatuar në vijimësi.

Për sa i përket formularit të vlerësimit të punës për periudhën e provës, ai është bërë sipas Lidhjes nr. 2, bashkëlidhur Vendimit nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për vlerësimin rezultateve në punë të nëpunësve civilë*” dhe është nënshkruar nga nëpunësit e përfshirë në procesin e vlerësimit të rezultateve në punë siç janë, Zyrtari Raportues, Zyrtari Kundërfirmues dhe Zyrtari Autorizues.

Konkluzion: Nga sa analizuam më sipër, Komisioneri vlerëson se, procedura e vendimmarrjes në fund të periudhës së provës nga eprori direkt, duke i konfirmuar nëpunës civilë punonjësit e kësaj kategorie, përgjithësisht është kryer në përputhje me kërkesat e ligjit, por, nga ana tjetër, konstatohet se për këtë kategori punonjësish, në fillim të periudhës

së provës, nuk është caktuar nëpunësi civil më i vjetër nën kujdesin e të cilit duhet të jetë nëpunësi në periudhë prove, e për pasojë, mungon vlerësimi me shkrim në dosjen e nëpunësve.

Kjo parregullsi, është e një natyre që nuk e cënon thelbin e procesit të konfirmimit, e për këtë arsye procedura do të vlerësohet si e realizuar, por, njësia përgjegjëse dhe eprorët direkt, duhet të tregojnë kujdes në vijimësi, që në të ardhmen, në praktikën e konfirmimit të nëpunësit në përfundim të periudhës së provës, të mos lejojë të tilla raste. Eprori direkt i nëpunësit, të caktojë punonjësin që do të mbikëqyrë nëpunësin në periudhë prove dhe para se të nxjerrë vendimin e arsyetuar të konfirmimit, krahas vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën e provës dhe certifikatës së trajnimit të detyrueshëm pranë ASPA-s, duhet të administrojë edhe mendimin e nëpunësit më të vjetër, nën kujdesin e të cilit është vendosur nëpunësi civil në periudhë prove.

Në zbatim të pikës 12, të kreut VI, “*Periudha e provës*”, të vendimit nr. 243, datë 18.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin , lëvizjen paralele , periudhën e provës, dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, pas njoftimit të konfirmimit të nëpunësit nga eprori direkt, është Njësia përgjegjëse ajo që ka detyrimin të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të nëpunësit dhe jo titullari i institucionit si në rastin konkret.

Konkluzion: Njësia përgjegjëse ka detyrimin ligjor për të plotësuar dhe nxjerrë aktet e deklarimit të statusit të nëpunësit, në mbështetje të pikës 12, të kreut IV, të VKM-së nr. 243, datë 18.3.2017. Këto akte duhet ti komunikohen Titullarit të institucionit vetëm për efekt të vulës.

IV. Dosjet e personelit

a. Dosja e personelit

Në zbatim të programit të mbikëqyrjes, u këqyrën dosjet e personelit, për të verifikuar nëse ato janë krijuar dhe administrohen në përputhje me përcaktimet e nenit 17, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar dhe kërkesave të Vendimit nr. 833, datë 28.10.2020, të Këshillit të Ministrave, “*Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrir qendror të personelit*”.

Nga këqyrja e akteve të administruara në dosjen individuale të çdo nëpunësi civil, në institucionin Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, u konstatua se, në dosjet personale të nëpunësve, administrohen dokumentet lidhur me nivelin e edukimit arsimor

dhe fushën e studimeve (*fotokopje e noterizuar e diplomës së shkollës së lartë dhe lista e notave*); dokumentet që vërtetojnë fillimin e marrëdhënieve të punës në pozicionin përkatës (*akti i emërimit*), si dhe aktet që provojnë procesin e deklarimit të statusit të punësimit, si dhe dokumenti që vërteton gjendjen gjyqësore, ndërsa vërtetimi i gjendjes shëndetësore (*Raporti Mjekësor*), nuk ishte rinovuar për vitin 2021.

Sjellim në vëmendje të institucionit se, vërtetimi i gjendjes shëndetësore, duhet të paraqitet pranë burimeve njerëzore të institucionit, brenda datës 10 janar të çdo viti, parashikuar në pikën 23, Kreu III, “*Lirimi nga shërbimi civil*”, të Vendimit nr. 124, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “*Për pezullimin dhe lirimimin nga shërbimi civil*”.

Në mënyrë të hollësishme këto akte janë materializuar në **aneksin nr. 2** “*Respektimi i kërkesave të përgjithshme, sipas nenit 21, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”*”, i ndryshuar, për punonjësit që janë aktualisht në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, në institucionin Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që është pjesë përbërëse e këtij raporti.

Nga grumbullimi i të dhënave konstatohet se, në këtë institucion, në momentin e mbikëqyrjes ka gjithsej **28 pozicione pune, pjesë e shërbimit civil**, nga të cilat konstatohet:

- **27** pozicione pune janë të plotësuara;
- **1** pozicion pune është i lirë (*nëpunësi ka bërë pezullim nga shërbimi civil për 2 vjet*);
 - ✓ **21** nëpunës civilë janë të gjinisë femërore, ose 75%;
 - ✓ **7** nëpunës civilë janë të gjinisë mashkullore, ose 25%;
 - Mosha mesatare për femrat është rreth **40** vjeç,
 - Mosha mesatare për meshkujt është rreth **39** vjeç,
 - Mosha mesatare në total është rreth **39,5** vjeç.

Për sa i përket arsimit të nëpunësve pranë KMD, rezultojnë të kenë diplomë të studimeve të larta universitare, të marra nga Universitetet Publike të Republikës së Shqipërisë dhe nga Universitetet e huaja, nga të cilat:

- **24** nëpunës zotërojnë diplomë të arsimit të lartë në institucione arsimore publike;
- **4** nëpunës zotëron diplomë të marrë në universitet të huaj (Greqi, Rusi dhe Itali), të njehsuar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Konkluzion: Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, dosjet e personelit janë të rregullta, të sistemuara dhe ruhen në kushte të përshtatshme, në ambientet e institucionit dhe administrohen nga Specialisti i Burimeve Njerëzore, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse, që është edhe njësi përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore për institucionin.

b. Regjistri i personelit

Regjistri Qendror i Personelit si sistemi që ruan dhe përpunon të dhënat elektronike për burimet njerëzore aktive në të gjitha institucionet e administratës shtetërore, është krijuar dhe administrohet nga Departamenti i Administratës Publike.

Institucionet e mbikëqyrura kanë akses në sistem dhe e ushtrojnë këtë funksion nëpërmjet nëpunësit të autorizuar. Në sistem bëhet plotësimi dhe përditësimi i të dhënave të parashikuara në lidhjen 3, “Administratorët dhe përdoruesit e RQP-së dhe platformës së bashkëpunimit “Administrata .al”, të drejtat dhe detyrimet”, që i bashkëlidhet Vendimit nr.833, datë 28.10.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

*
* *

Këto ishin rrethanat e konstatuara nga grupi i punës gjatë procesit të mbikëqyrjes në institucionin Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në lidhje me veprimet administrative të kryera nga njësia përgjegjëse dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e administrimit të shërbimit civil, prej momentit të fillimit të efekteve të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, e në vijim.

Aktet administrative që dokumentojnë procesin e mbikëqyrjes në institucionin Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, sipas pikave të këtij raporti, janë materializuar në tabelat si më poshtë:

Aneksi 1 “Aktet që materializojnë procesin e njohjes së statusit të punësimit për punonjësit që punojnë në pozicione pune të shërbimit civil, në momentin e mbikëqyrjes, në institucionin Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Aneksi 2 “Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, për punonjësit që janë të emëruar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil në momentin e mbikëqyrjes, në institucionin Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Tabela 1 “Plani vjetor për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil”.

Tabela 2 “Të dhëna përmbledhëse për konkurrimet e realizuara ndër vite”.

Tabela 3 *“Të dhëna për plotësimin e pozicioneve të nivelit ekzekutiv nëpërmjet lëvizjes paralele dhe pranimit në shërbimin civil”.*

Tabela 4 *“Të dhëna për plotësimin e pozicioneve të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues nëpërmjet lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë”.*

Tabela 5 *“Të dhëna në lidhje me përputhshmërinë e kriterëve të pozicionit të punës nga kandidatët e kualifikuar”.*

K O M I S I O N E R I

Pranvera STRAKOSHA